



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport i auditimit të ushtruar në Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare
për projektin “Përmirësimi i sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI

“AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”

NË

KORPORATËN ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE PËR
PROJEKTIN “PËRMIRËSIMI I SIGURISË SË DIGËS NË
HIDROCENTRALIN E KOMANIT”

TIRANË, tetor 2025

NR.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	5
II	HYRJA	6
1	Objektivat dhe qëllimi	6
2	Identifikimi i çështjes	6
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
4	Përgjegjësitë e audituesve	7
5	Kriteret e vlerësimit	7
6	Standardet e auditimit	7
7	Metodat e auditimit	7
8	Dokumentimi i auditimit	7
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	8
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	10
2.1	Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimit i ndryshimeve.	10
2.2	Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.	11
2.3	Mbi menaxhimin financiar të programit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave	14
2.4	Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të prokurimit të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacioni shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.	21
2.5	Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra dhe konsulencë.	24
2.6	Mirëmbajtja, vlerësimet mbi gjendjen e komponentëve të projekteve për sigurinë e digës dhe masat e marra për përmirësimin e tyre.	29
IV	REKOMANDIME	34

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
IDA	Shoqata ndërkombëtare për zhvillim;
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
IBRD	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim;
SECO	Qendra e Konfederatës Zvicerane;
KfW	Instituti i Kreditimit të Investimeve;
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
AK	Autoriteti Kontraktor
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
sh.a.	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

I. 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

a. Përshkrim i shkurtër i Projektit: “Përmirësimi i sigurisë së Digës në hidrocentralin e Komanit”, është projekt i cili është financuar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim si hua, me vlerë 12,700,000 euro, me objekt ndërhyrje rehabilituese në pjesën fundore të digës, konsolidimin e bjeftit të poshtëm si dhe fuqizimin e masave për mbrojtjen nga rënia e shkëmbinjve në hidrocentralin e Komanit. KESH sh.a., e ka zbatuar Projektin, duke lënë pa shpenzuar nga huaja në vlerën prej 6,128,224 euro. Më datë 21.12.2016, EBRD ka njoftuar Ministrinë e Financave për shtyrjen e afatit të disponibilitetit të shumës së mbetur pas kërkesës së marrësit deri më 31.12.2018. Me ligjin nr. 88/2018, datë 22.11.2018, u ndryshua marrëveshja fillestare, duke zgjeruar përkufizimin e Projektit, në mënyrë që të kryhej rehabilitimi i portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit.

Projekti është miratuar me aktet ligjore të mëposhtme:

- Ligji nr.103/2013, datë 25.03.2013 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit” e datës 31.12.2012.

- Ligji nr. 88/2018, datë 22.11.2018 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Ndryshuese Nr.1 e Marrëveshjes së Huas, të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e Projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit.

- Ligji Nr. 61/2018, datë 20.09.2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”.

b. Rëndësia e Projektit. Projekti ka rëndësi për rritjen e sigurisë së digës së Komanit, duke përmirësuar funksionalitetin e portave të shkarkimit.

c. Qëllimi i auditimit është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord; verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, i cili përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare; raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Raportimi mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

-Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre.

-Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit.

-Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve, kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

-Mbi auditimin e zbatimit të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.

-Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime.

-Të tjera çështje të dala gjatë auditimit.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave: Në varësi të specifikave të subjektit të auditimit, në programin e auditimit paraqiten veçmas ose të kombinuara përdorimi i metodave dhe teknikave të mëposhtme:

- Verifikimi i transaksioneve - kur është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, atëherë ky informacion mund të krahasohet me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër.

- Intervistimi - është metoda e marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet. Për shkak se kjo metodë mbart rrezikun e subjektivitetit duhet shqyrtuar nëse evidenca e arritur gjatë përdorimit të një metode të tillë është plotësisht e besueshme.

- Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve duhet të lidhet me objektivat e auditimit dhe problemet që lidhen me të. Raportet mund të tregojnë gjithashtu dhe vëmendjen që u është kushtuar mangësive të mëparshme, por që nuk është marrë asnjë masë për eliminimin e tyre.

- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm - audituesi duhet të marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve.: Në përfundim të auditimit kanë rezultuar 6 gjetje dhe janë dhënë 7 rekomandime.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Në vitin 2008 ka filluar Projekti “Fuqizimi i programit të Sigurisë së Digave” me bashkëfinancim të donatorëve të ndryshëm, IDA –Shoqata ndërkombëtare për zhvillim; EBRD –Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim; IBRD –Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim; SECO –Qendra e Konfederatës Zvicerane; KfW –Instituti i Kreditimit të Investimeve, me objekt rritjen e sigurisë së digave të hidrocentraleve në kaskadën e Drinit. Huaja e marrë nga BERZH në vitin 2012 në shumën 12,700,000 euro për përmirësimin e sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit nuk u shfrytëzua plotësisht duke lënë vlerën 6,128,224 euro kredi jo e disbursuar. Më datë 21.12.2016 EBRD ka njoftuar Ministrinë e Financave për shtyrjen e afatit të disponibilitetit të shumës së mbetur pas kërkesës së marrësit deri më 31.12.2018.

Në raportet e projektit të Bankës Botërore për Sigurinë e Digave, me nr. P110481, filluar më datë 31.12.2013 dhe përfunduar më datë 31.12.2016, është evidentuar nevoja për rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC-it të Fierzës dhe Komanit dhe përfaqësuesi i IBRD i ka dërguar një shkresë Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës, për dijeni dhe Ministrisë të Financave ku parashtron urgjencën e rehabilitimit të portave të shkarkimit, bashkëpunimin intensiv me KESH SHA për finalizimin e plotësimin të dokumenteve të procedurës së prokurimit, si dhe kërkon bashkëpunimin e të gjithë institucioneve për t’i kompletuar deri në shtator të 2016.

-Drejtuesi i Njësisë së Menaxhimit të Projekteve ka ndërmarrë veprime për zhvillimin e procedurës së prokurimit për llogari të IBRD, sipas rregulloreve të kësaj banke, me zbatues KESH, me objekt rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC-it të Fierzës dhe Komanit, në periudhën maj-shtator 2016 pa pasur një autorizim ose urdhër nga titullari i KESH, veprim në kundërshtim me neni 14.4 të Statutit të Shoqërisë, të ndryshuar, miratuar me shkresën nr. 2216/1 prot., datë 26.04.2011 të Aksionerit të Përgjithshëm METE, dhe Rregulloren e Shoqërisë të vitit 2014, ku përcaktohen qartë kompetencat e administratorit dhe drejtuesit të Njësisë së Menaxhimit të Projekteve, duke mos pasur kompetenca për të përfaqësuar shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët.

- Në lidhje me procedurën e filluar në maj të vitit 2016 nga drejtuesi i Njësisë së Menaxhimit të Projekteve të KESH SHA, për llogari të IBRD, me objekt rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC-it të Fierzës dhe Komanit, administratori i KESH SHA, me shkresën nr. 41, datë 19.09.2016, nr. 7801 prot., ka urdhëruar ngritjen e një komisioni për vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik, bazuar në Ligjin nr. 40/2012 datë 12.04.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).

Urdhri i mësipërm nuk është i saktë pasi marrëveshja e huasë ishte e përfunduar në momentin e lëshimit të urdhrin.

Më datë 10.10.2017 administratori i KESH SHA, i është drejtuar shoqërisë C. A.S, me shkresën nr. 5126 prot., për ta njoftuar se oferta e tyre në vlerën 12.340.903 euro për dy lotet është pranuar, dhe më datë 07.06.2018 është firmosur kontrata me nr. DSP-IDA 05-16, pa numër protokoli.

Ministri i Financave me shkresën me nr. 17494 prot., datë 01.12.2017 i ka kërkuar Bankës Botërore akordimin e një financimi shtesë në vlerën e 12,000,000 euro, në kuadër të marrëveshjes së mëparshme për Sigurinë e Digave.

Më datë 21.06.2018 është pranuar marrëveshja ndërmjet IBRD dhe KESH SHA për huanë me nr. 8862-AL në lidhje me implementimin e projektit, e firmosur nga administratori i KESH SHA dhe përfaqësuesi i IBRD. Kontrata nuk ka numër protokoli të KESH. Administratori i KESH SHA nuk kishte kompetenca për lidhjen e marrëveshjes me IBRD pasi Kuvendi i Shqipërisë e ka ratifikuar marrëveshjen e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, në vlerën 12,000,000 euro, më datë 20.09.2018.

Në shtojcën e ligjit, pikat 5-6 përcaktohet se “bashkë-financues” është Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe shuma është 6,100,000 euro.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 12879/6 prot., datë 19.10.2018 i ka dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe KESH SHA kopjen e dokumentit ndryshues të marrëveshjes së huasë me BERZH.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se përfaqësuesit e KESH SHA, konkretisht administratori dhe drejtuesi i Njësisë së Menaxhimit të Projekteve, kanë iniciuar procedura prokurimi pa pasur në dispozicion miratimin e financimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe pa ratifikimin përkatës nga Parlamenti i Shqipërisë. Si rrjedhojë, kontratat janë lidhur në mungesë të një financimi të aprovuar dhe të ratifikuar nga këto institucione. Veprimet e ish administratorit të KESH janë në kundërshtim me statutin e shoqërisë KESH SHA, neni 11, pikat iv, v dhe vi, ku përcaktohet se angazhimet për lidhjen e detyrimeve të reja financiare fillimisht miratohen në Këshillin Mbikëqyrës për të kaluar në aprovimin përfundimtar të Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

- Referuar nenit 2, pika h, e Marrëveshjes së Financimit, norma e tarifës së angazhimit do të jetë 0.5 % në vit për t’u llogaritur dhe e pagueshme në përputhje me seksionin 3.05 të termave dhe kushteve standarde. Nga auditimi rezultoi se për shkak të zgjatjes së afatit të zbatimit të projektit, mos disbursimit në kohë dhe jo sipas skedulit të parashikuar në marrëveshjen e financimit të huasë të fondeve të vendosura në dispozicion, Ministria e Financave ka paguar ndaj EBRD vlerën prej 316,624.52 euro, e cila është kosto shtesë për Ministrinë e Financave dhe KESH SHA.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave janë dhënë rekomandimet si vijon:

- Administratori i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare SHA të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim parandalimin e rasteve kur punonjësit ndërmarrin veprime në emër të shoqërisë pa pasur miratimin apo urdhrat përkatës. Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës Elektroenergjetike të Shqipërisë të marrë masat që, në të ardhmen, procedurat që lidhen me investimet, huamarrjen dhe përfaqësimin e shoqërisë ndaj

palëve të treta të realizohen vetëm pas autorizimit nga Këshilli Mbikëqyrës dhe miratimit nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

- Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë, të marrë masa që në implementimin e projekteve me financim të huaj ti përmbahet grafikut kohor të zbatimit të tij, me qëllim eliminimin e efekteve financiare dhe rritjen e kostos së tij.

I.3. Konkluzioni

Projekti “Përmirësimi i sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”, është në vijimësi të studimeve dhe vëzhgimeve të kryera në periudhën 2006-2008, në digat e lumit Drin, për gjendjen teknike të tyre, nga ku ka rezultuar se duhej ndërhyrë për përmirësimin e situatës. Këto studime shërbyen si baza e përgatitjes së implementimit të investimit me objekt ndërhyrje rehabilituese në pjesën fundore të digës dhe të portave të shkarkimit në hidrocentralin e Komanit.

Për financimin e projektit u ratifikua marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me vlerën 12,700,000 euro, me Ligjin nr. 103/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”.

Administratori i KESH SHA dhe Drejtori i Njësisë së Zbatimit të Projektit, në lidhje me implementimin e projektit për rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe të portave të sigurisë për Hidrocentralin e Fierzës dhe të Komanit kanë zhvilluar takime bashkëpunimi me huadhënësin pa pasur fonde të miratuara nga Ministria e Financave si përfaqësues i Shtetit Shqiptar në marrëveshjet e huave. Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga periudha mars 2016 deri më tetor 2017, në vlerën 12,340,903 euro për dy lotet duke lidhur dhe kontratë me operatorin fitues.

Në tërësi qëllimi i projektit është realizuar brenda vlerës së huasë, por për shkak të zgjatjes së afatit të zbatimit të projektit, mos disbursimit në kohë dhe jo sipas skedulit të parashikuar në marrëveshjen e financimit të huasë të fondeve të vendosura në dispozicion, Ministria e Financave ka paguar ndaj EBRD vlerën prej 316,624.52 euro, e cila është kosto shtesë për Ministrinë e Financave dhe KESH SHA.

Në bazë të marrëveshjes së huasë është lidhur Marrëveshje nënhuaje midis Ministrisë së Financave dhe Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, ku detyrimet financiare të parashikuara në marrëveshje i kanë kaluar KESH SHA. Nga auditimi rezulton se të vetmet pagesa që KESH SHA ka kryer ndaj Ministrisë së Financave janë për interesin në shumën 3,382 euro (pagesë e kryer në vitin 2014) dhe për komisione në shumën 99,739 euro (pagesë e kryer në vitin 2014).

KESH SHA ka një detyrim të mbartur ndaj Ministrisë së Financave në shumën 9,820,643 euro për detyrime të papaguara për këtë hua duke ngarkuar buxhetin e shtetit për shkak të mos pagesës, e cila përbën përdorim jo efektiv të buxhetit të shtetit.

Në lidhje me procesin e dorëzimit të punëve civile dhe pajisjeve u konstatua se procesi i marrjes në dorëzim është kryer nga Njësia e Menaxhimit të Projekteve sipas kërkesave të kontratës, por nga ana e KESH SHA procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve nuk është bërë në përputhje pikat 42, 43 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 316/1, prot., datë

10.03.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 10.03.2025 deri në datën 02.05.2025, në subjektin Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) për projektin “Përmirësimi i sigurisë së Digës në hidrocentralin e Komanit” për periudhën nga fillimi i projektit deri në datën 31/12/2024 u krye auditimi “Mbi Përputhshmërinë e Projektit “Përmirësimi i sigurisë së Digës në hidrocentralin e Komanit ” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. B. Sh., përgjegjës grupi
2. I. S., anëtare
3. M. G., anëtare
4. F. D., anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit:

Dhënia e opinionit dhe një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve si dhe nëse është kryer përdorimi i përshtatshëm i fondeve të projektit.

Raportimi mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

2. Identifikimi i çështjes:

Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve, kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave. Mbi auditimin e zbatimit të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës. Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime. Të tjera çështje të dala gjatë auditimit.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Njësia e Menaxhimit të Projekteve në Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) është përgjegjëse për koordinimin e punës, hartimin dhe ndjekjen e aspekteve teknike, ekonomike, mjedisore e administrative të projektit, supervizimin e tij deri në dorëzim.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjekteve të audituara lidhur me çështjet nën auditim. Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

4. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia jonë është që të arrijmë në konkluzione në lidhje me implementimin e projektit shkallën e realizimit të objektivave etj. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

5. Kriteret e vlerësimit:

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr.103/2013, datë 25.03.2013 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”.

Ligji nr. 88/2018, datë 22.11.2018 “Për ratifikimin e *Marrëveshjes Ndryshuese Nr.1 e Marrëveshjes së Huas, të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e Projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit.*

Ligji nr. 61/2018, datë 20.09.2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave”.

Ligji nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Ligji nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC, etj.

7. Metodatat e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm, me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

8. Dokumentimi i auditimit:

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt konstatimeve si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar do të përgatitet Raporti Përfundimtar i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Në kuadër të objektivave të programit rajonal për Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore, është firmosur Marrëveshja Financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA) si dhe Marrëveshja e Projektit ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH SHA) dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA) në lidhje me Projektin e Sigurisë së Digave në hidrocentralet e kaskadave të lumenjve Drin dhe Mat. Objektivat kryesore të Projektit të Sigurisë së Digave në kuadrin e programit rajonal ECSEE APL5 janë:

- *Rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat;*

- *Rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të eficiencës së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e qëndrueshme të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në tregun rajonal të energjisë;*

Projekti i Sigurisë së Digave, është projekt i një rëndësie prioritare për sistemin elektroenergjetik dhe për Shqipërinë. Realizimi i projektit të sigurisë së digave, krijon të gjitha premisat për rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet optimizimit të përdorimit të rezervës hidroenergjetike në kaskadat e lumenjve Drin si dhe nëpërmjet instalimit të sistemeve moderne të kontrollit dhe automatizimit. Nëpërmjet një mirë menaxhimi të hidrocentraleve ekzistuese rritet vlera e aseteve të gjenerimit si dhe krijohen mundësitë për një pjesëmarrje efektive të Shqipërisë në tregun rajonal të energjisë elektrike. “Studimi mbi Sigurinë e Digave të hidrocentraleve të kaskadave të lumenjve Drin dhe Mat”, i financuar në vitin 2006 nga

Qeveria Zvicerane e përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO), bëri një analizë të thellë të gjendjes të këtyre digave në Shqipëri.

Me përfundimin e studimit të detajuar të fizibilitetit i financiar nga Qeveria Zvicerane e përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO), i cili shërbeu si bazë për përgatitjen e Projektit për implementimin e të gjitha investimeve të parashikuara në kuadrin e projektit të Sigurisë së Digave. Projekti i implementimit të masave për Sigurinë e Digave ishte parashikuar të realizohej nëpërmjet një financimi të përbashkët të Bankës Botërore institucioneve të tjera financiare si SECO, EBRD, KfW, etj.

Për realizimin e projektit “Përmirësimi i sigurisë së Digës në hidrocentralin e Komanit” është marrë huaja në vlerën 12,700,000 euro nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) e cila është ratifikuar në parlament me Ligjin nr. 103/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”.

Huamarrësi, nëpërmjet Njesisë së Projektit, ka zbatuar Projektin, duke mos shpenzuar huanë në shumën totale prej 6,128,224 eurosh. Më datë 21.12.2016 EBRD ka njoftuar Ministrinë e Financave për shtyrjen e afatit të disponibilitetit të shumës së mbetur pas kërkesës së marrësit deri më 31.12.2018.

Në raportet mbikëqyrëse të projektit të Bankës Botërore për Sigurinë e Digave, me nr. P110481, filluar më datë 31.12.2013 dhe përfunduar më datë 31.12.2016, është evidentuar nevoja për rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC-it të Fierzës dhe Komanit.

Më datë 27.06.2016, përfaqësuesi i Bankës Botërore i ka dërguar një shkresë Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës, për dijeni dhe Ministrit të Financave ku parashtron urgjencën e rehabilitimit të portave të shkarkimit, bashkëpunimin intensiv me KESH për finalizimin e plotësimin të dokumenteve të procedurës së prokurimit si dhe kërkon bashkëpunimin e të gjithë institucioneve për ti kompletuar në shtator të 2016.

Procedura e prokurimit është publikuar në portalin e prokurimeve të Kombeve të Bashkuara me nr. Reference WB3079-07/16, nga Banka Botërore më datë 12.07.2016 me afat deri më 15.09.2016.

Administratori i KESH sh.a., dhe Drejtori i Njesisë së Zbatimit të Projekteve, kanë bashkëpunuar me IBRD në lidhje me implementimin e projektit për rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe të portave të sigurisë për Hidrocentralin e Fierzës dhe të Komanit.

Gjithashtu kanë zhvilluar procedurat e prokurimit nga mars 2016 deri më tetor 2017, në vlerën 12.340.903 euro për dy lotet dhe kanë lidhur kontratë me operatorin fitues të C. A.S.”, Turqi.

Në dhjetor të 2017, Ministri i Financave, i ka kërkuar Bankës Botërore akordimin e një financimi shtesë në vlerën e 12,000,000 euro, në kuadër të marrëveshjes së mëparshme për Sigurinë e Digave.

Më datë 20.09.2018, me ligjin nr. 61/2018, Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar marrëveshjen e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, për vlerën 12,000,000 euro. Në shtojcën e ligjit, pikat 5-6 përcaktohet se “bashkë-financues” është Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe shuma është 6,100,000 euro.

Pra objekti i projektit, rehabilitimi i portave të shkarkimit dhe të portave të sigurisë për Hidrocentralin e Komanit është iniciuar fillimisht si pjesë e një programi ekzistues të IBRD.

KESH SHA, i ka zhvilluar të gjitha etapat deri në lidhjen e kontratës me operatorin fitues duke vënë në dijeni Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, por pa pasur aprovim nga Ministri i MIE dhe Ministri i MF si dhe ratifikim në parlament për miratimin e financimit nga BERZH.

Më datë 20.09.2018, me ligjin nr. 61/2018, Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar marrëveshjen e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, në vlerën 12,000,000 euro.

Në skedulën nr.1, Përshkrimi i Projektit, pjesa e parë konsiston në investime në infrastrukturën e sigurisë së digave, pjesa b) në rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe të portave segmente të sigurisë në Hidrocentralin e Komanit. Në sektorin III, të prokurimit janë përcaktuar modalitetet dhe udhëzimet e prokurimit si kontratat e lidhura në bazë të tenderimit konkurrues ndërkombëtar.

Në shtojcën e ligjit, pikat 5-6 përcaktohet se “bashkë-financues” është Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe shuma është 6,100,000 euro.

Më datë 29.09.2018, Huamarrësi dhe BERZH-i kanë ndryshuar Marrëveshjen Fillestare, me qëllim që të zgjerojnë përkufizimin e Projektit, në mënyrë që të përfshijë edhe rehabilitimin e portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit duke mundësuar që kursimet në vlerën 6,128,224 euro, të aplikohen për financimin e elementeve të reja të Projektit. Marrëveshja ndryshuese është ratifikuar me ligjin nr. 88/2018 dhe miratuar datë 22.11.2018.

Më datë 19.10.2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 12879/6 Prot., i ka dërguar MIE dhe KESH kopjen e dokumentit ndryshues të marrëveshjes së huasë me BERZH. Qëllimi i kredisë është që Huamarrësi do të përdorë Huan ekskluzivisht për financimin e Programit.

Në tërësi qëllimi i projektit është realizuar në afatet e përcaktuara dhe brenda vlerës së huasë.

Në lidhje me procesin e dorëzimit të punëve civile dhe pajisjeve u konstatua se procesi i marrjes në dorëzim është kryer nga Njësia e Menaxhimit të Projekteve sipas kërkesave të kontratës por nga ana e KESH sh.a., procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve nuk është bërë në përputhje me nenet dhe pikat 42, 43 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e tyre nëse kanë, shkaqet dhe argumentimi i tyre.

Për realizimin e projektit “*Përmirësimi i Sigurisë së Digës në Hidrocentralin e Komanit*” është marr kredia nga BERZH në vlerën 12.7 milion euro, e ratifikuar me ligjin nr.103/2013, datë 25.03.2013 “*Marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit*” e datës 31.12.2012. Sipas kësaj marrëveshje Huamarrësi (R.SH përfaqësuar nga Ministria e Financave) ka për qëllim që të vërë në jetë projektin me qëllim forcimin (rritjen) e sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, në Shqipëri. Projekti do të kryhet nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (entiteti i projektit) me ndihmesë financiare nga huamarrësi. Huamarrësi ka kërkuar ndihmesë nga Banka për financimin e një pjese të projektit.

Sekretariati Shtetërorë Zviceran (Swiss Secretariat for Economic Affairs) ka dhënë një grant në shumën 5,330,000 euro për përgatitjen e studimit të realizueshmërisë (fizibilitetit) dhe financimin e disa pjesëve të projektit.

Për sa më sipër si dhe pjesë e objektit të auditimit, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka rënë dakord që t’i japë një hua Huamarrësit në shumën 12,700,000 euro, sipas termave dhe kushteve të parashikuara apo të referuara në këtë marrëveshje.

Nga auditimi rezulton se është lidhur marrëveshja e nënhuasë midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare me datë 24.01.2013.

Për sa i përket termave financiarë të huasë (shuma dhe monedha), në marrëveshje përcaktohet se shuma e huasë që BERZH-i do t'i japë Huamarrësit nuk tejkalon 12,700,000 euro.

Qëllimi i projektit është që të ndihmojë Huamarrësin në financimin e programit të investimeve të entitetit të projektit për:

- a) shtratin rrjedhës të digës dhe zonën e gërryerjeve të digës në hidrocentralin e Komanit; dhe
- b) masat për mbrojtjen nga shkëmbinjte, me qëllim forcimin e sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, në Shqipëri.

Projekti konsiston në pjesët në vijim, subjekt i ndryshimeve që mund të ndodhin e mund të bien dakord kohë pas kohe nga Banka dhe Huamarrësi:

Pjesa A: Ndërhyrje rehabilituese në pjesën fundore të digës dhe konsolidimi i bjefit të poshtëm.

Pjesa B: Fuqizimi i masave për mbrojtjen nga rënia e shkëmbinjve; të dyja në hidrocentralin e Komanit, në Shqipëri.

Kategoritë, shuma e huas e caktuar për çdo kategori dhe përqindja e shpenzimeve për t'u financuar në secilën kategori paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Shuma e huas e caktuar në monedhën e huas	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar
1.Mallra dhe punime për pjesën A	10,000,000 euro	100% e vlerës së kontratës, duke përjashtuar çfarëdo takse
2.Mallra dhe punime për pjesën B	2,573,000 euro	100% e vlerës së kontratës, duke përjashtuar çfarëdo takse
3. Komisioni fillim-mbarim	127,000 euro	100 %
Totali	12,700,000 euro	100 %

Në marrëveshjen e huas përcaktohet se asnjë tërheqje nuk do të bëhet në lidhje me shpenzimet e shkaktuara përpara datës së kësaj marrëveshje.

Huamarrësi, nëpërmjet Njësisë së Projektit, ka zbatuar Projektin duke arritur objektivat e përcaktuara, duke arritur kursimet e huas në shumën totale prej 6,128,224 euro.

2. Me ligjin nr. 88/2018, datë 22.11.2018 është ratifikuar “Marrëveshja Ndryshuese Nr.1 e Marrëveshjes së Huas, të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e Projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”, ratifikuar me ligjin nr.103/2013. Në bazë dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje Ndryshuese, Huamarrësi dhe BERZH-i dëshirojnë të ndryshojnë Marrëveshjen Fillestare, me qëllim që të zgjerojnë përkufizimin e Projektit, në mënyrë që të përfshijnë edhe rehabilitimin e portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit dhe të sigurojë që kursimet e kredisë (6,128,224 euro) do të aplikohen për financimin e elementeve të reja të këtij Projekti.

Kjo marrëveshje ka ndryshuar skedulin e programit:

Kategoria	Shuma e huas, e alokuar në monedhën e kredisë	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1. Mallrat dhe punimet për pjesën A	5,619,575 euro	100% e vlerës së kontratës, duke përjashtuar çdo taksë

2. Mallrat dhe punimet për pjesën B	825,201 euro	100% e vlerës së kontratës, duke përjashtuar çdo taksë
3. Mallrat dhe punimet për pjesën C	6,128,224 euro	100% e mallrave dhe e punimeve për pjesën C, duke përjashtuar taksat
4. Komisioni <i>Front - End</i>	127,000 euro	100%
TOTALI	12,700,000 euro	100%

Me efekt në dhe nga data e hyrjes në fuqi, seksionet 1 dhe 2 të përfshira në Marrëveshjen Fillestare fshihen në tërësinë e tyre dhe zëvendësohen përkatësisht me seksionin 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese.

Emërtimet “Ministria e Financave” dhe “Ministri i Financave” ndryshohen në “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” dhe “Ministri i Financave dhe Ekonomisë” kudo ku përdoren në tekstin e Marrëveshjes Fillestare.

Seksioni 2.02 (f) ndryshohet në: “Data e fundit e disponueshmërisë është 31 dhjetor 2021 ose në atë datë të mëvonshme që mund të bihet dakord me shkrim ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit”.

2.2 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit.

Në kuadër të objektivave të programit rajonal për Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore, është firmosur Marrëveshja Financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA) si dhe Marrëveshja e Projektit ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH SHA) dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA) në lidhje me Projektin e Sigurisë së Digave në hidrocentralet e kaskadave të lumenjve Drin dhe Mat. Objektivat kryesore të Projektit të Sigurisë së Digave në kuadrin e programit rajonal ECSEE APL5 janë:

- *Rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat;*

- *Rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të efikasitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e qëndrueshmërisë të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në tregun rajonal të energjisë;*

Projekti i Sigurisë së Digave, është projekt i një rëndësie të veçantë për sistemin elektroenergjetik të Shqipërisë. Realizimi i projektit të sigurisë së digave, krijon të gjitha premiset për rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet optimizimit të përdorimit të rezervës hidroenergjetike në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat si dhe nëpërmjet instalimit të sistemeve moderne të kontrollit dhe automatizimit. Nëpërmjet një mirë menaxhimi të hidrocentraleve ekzistuese do të rritej vlera e aseteve të gjenerimit si dhe do të krijoheshin mundësitë për një pjesëmarrje efektive të Shqipërisë në tregun rajonal të energjisë elektrike “Studimi mbi Sigurinë e Digave të hidrocentraleve të kaskadave të lumenjve Drin dhe Mat”, i financuar në vitin 2006 nga Qeveria Zvicerane e përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO), ka bërë një analizë të thellë të gjendjes aktuale të këtyre digave në Shqipëri. Investimet e identifikuara nga ky studim mund të përmbledhen nëpërmjet realizimit komponentëve si më poshtë;

- Rehabilitimin e veprave shkarkuese;

- Instalimin e sistemeve të reja të kontrollit dhe monitorimit;

- Mbrojtjen nga rreziku i rënies së shkëmbinjve rreth shpateve të digave;

- Përmirësimin dhe garantimin e rrugëve hyrëse në godinat e centraleve, digave dhe galerive të drenazhit;
- Studimin batimetrik të baseneve;
- Rishikimin e hidrologjisë së kaskadave të lumenjve Drin dhe Mat;
- Punimet në bjefet e poshtme të këtyre hidrocentraleve me qëllim eliminimin e sedimenteve të ngurta, etj.

Me përfundimin e studimit të detajuar të fizibilitetit i financuar nga Qeveria Zvicerane e përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO), i cili shërbeu si bazë për përgatitjen e Projektit për implementimin e të gjitha investimeve të parashikuara në kuadrin e projektit të Sigurisë së Digave. Projekti i implementimit të masave për Sigurinë e Digave është realizuar nëpërmjet një financimi të përbashkët të Bankës Botërore institucioneve të tjera financiare si SECO, EBRD, KfW, etj. Masat mbrojtëse për shpatet e digave kanë përfunduar sa i përket HEC Fierzë dhe Koman.

Për realizimin e projektit “Përmirësimi i sigurisë së Digës në hidrocentralin e Komanit” është marrë huaja në vlerën 12,700,000 euro nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) e cila është ratifikuar në parlament me Ligjin nr. 103/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”.

Në kuadër të auditimit të përputhshmërisë, u analizua shkalla e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit "Përmirësimi i Sigurisë së Digës në Hidrocentralin e Komanit" në raport me detyrimet e përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësin. Vlerësimi u bazua në dokumentacionin kontraktual, raportet e progresit dhe të dhënat financiare të lidhura me projektin. Bazuar në marrëveshje parashikohet:

Programi ka të bëjë me investimet e entitetit të projektit për: a) shtratin e rrjedhës së digës dhe zonën e gjërryerjeve të digës së hidrocentralit të Komanit; dhe b) masat për mbrojtjen nga shkëmbinjtë, me qëllim forcimin e sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, në Shqipëri. Pas mos shpenzimit të një pjese të konsiderueshme të kredisë prej 6,128,224 eurosh, më datë 21.12.2016 EBRD ka njoftuar Ministrinë e Financave për shtyrjen e afatit të disponibilitetit të shumës së mbetur pas kërkesës së marrësit deri më 31.12.2018.

Më datë 20.09.2018, me ligjin nr. 61/2018, Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar marrëveshjen e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, për vlerën 12,000,000 euro. Në projektin për “Sigurinë e Digave” është parashikuar dhe remonti i portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit, por për këtë pjesë të shfrytëzohej financimi nga BERZH.

Në skedulën nr.1, Përshkrimi i Projektit, pjesa e parë konsiston në investime në infrastrukturën e sigurisë së digave, pjesa b) në rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe të portave segmente të sigurisë në Hidrocentralin e Komanit. Në sektorin III, të prokurimit janë përcaktuar modalitetet dhe udhëzimet e prokurimit si kontratat e lidhura në bazë të tenderimit konkurrues ndërkombëtar.

Në shtojcën e ligjit, pikat 5-6 përcaktohet se “bashkëfinancues” është Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe shuma është 6,100,000 euro.

Me amendimin nr. 1 datë 28.09.2018 është zgjeruar koncepti i përdorimit të kredisë për pjesën e mbetur pa shpenzuar nga kredia si dhe afatin e vlefshmërisë së saj deri në 31.12.2021. Ky amendim është ratifikuar me Ligjin nr. 88/2018 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndryshuese nr. 1, të Marrëveshjes së Huas, të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës

Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e Projektit “Përmirësimi i sigurisë së Digës në hidrocentralin e Komanit”, ratifikuar me Ligjin nr. 103/2013”.

HEC-i i Komanit, për arsye të kohës së ndërtimit, nuk ishte përfshirë në Projektin e Rehabilitimit të Kaskadës së Lumit Drin i nisur në vitin 1995, dhe nuk ka marrë investime madhore që nga ndërtimi. Megjithatë, hidrocentrali i Komanit është hidrocentrali më i madh në Shqipëri, ndaj ruajtja e standardeve të larta të impiantit është e një rëndësie të madhe për furnizimin me energji elektrike. Prandaj, megjithëse nuk ka të bëjë me “sigurinë e digave”, rehabilitimi i pajisjeve hidromekanike, pajisjeve elektrike dhe instalimi i një sistemi të ri monitorimi kontrolli është përfshirë në Projektin e “Sigurisë së Digës”.

Gjatë fazës së ndërtimit të digës së Komanit u konstatuan prurje të shumta të ujit në nivelet e themeleve. Zgjidhja inxhinierike në atë kohë ishte ndërtimi i mureve anësorë në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme, në mënyrë që ndërtimi i mbrojave të shkëmbinjve të mund të vazhdonte pa pengesa.

Daljet e derdhjes ndikojnë në zonën e poshtme të digës. Operacionet e derdhjes në të kaluarën në Koman kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në këtë zonë, duke shkatërruar një pjesë të strukturës së betonit për mbrojtjen e centralit. Ndikimi krijoi gjithashtu një pishinë të gjerë (rreth 20 metra të thellë) dhe valët e ujërave të pasme kanë gërryer ndjeshëm pjesën fundore të digës.

Përpara kontratës ndërmjet KESH-it dhe A-së (kompani konsulence), ishte kryer një studim fizibiliteti nga një kompani tjetër konsulente, e cila kishte vendosur parimet e përgjithshme të punës që do të bëhej dhe kishte krijuar bazën për financimin e Projektit dhe përcaktimin e shumave totale të disponueshme për punën, nga agjencitë e ndryshme financuese.

Duke ndjekur udhëzimet e përcaktuara më parë nga Konsulenti, u miratua një qasje e konsoliduar për planifikimin e punës së rehabilitimit. Gjatë fazës fillestare u rishikuan të gjitha aspektet e strukturës së çelikut hidraulik të stacioneve duke përfshirë punimet civile, funksionimin e pajisjeve elektrike dhe mekanike.

Në përfundim të projektit kostot sipas komponentëve janë:

EBRD Kredi (EUR 12,700,000)	Vlera totale e kontratës	Vlera totale e disbursuar deri më 31.12.2021	Vlera e pa disbursuar 31.12.2021	% e disbursimit
EBRD Loan (EUR, 12,700,000)	12,700,000.00	12,693,426.34	6,573.66	99.9%
Kategoria 1. Mallrat dhe punimet A	5,619,575.00	5,613,000.43	6,574.57	100%
Kategoria 1. Mallrat dhe punimet B	825,201.00	825,201.91	(0.91)	100%
Kategoria 1. Mallrat dhe punimet C	6,128,224.00	6,128,224.00	-	100%
Kategoria 4. Komisione	127,000.00	127,000.00	-	100%
<i>Vlera e mbetur pas realizimit të kontratës</i>	<i>12,700,000.00</i>	<i>12,693,426.34</i>	<i>6,573.66</i>	

Burimi: KESH sh.a.

Ecuria e disbursimeve në vite:

2.3 Mbi menaxhimin financiar të programit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Për realizimin e projektit “Përmirësimi i sigurisë së Digës në hidrocentralin e Komanit” është marr huaja në vlerën 12,700,000 euro nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) e cila është ratifikuar në parlament me Ligjin nr. 103/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit”.

Banka ka rënë dakord që t’i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të parashikuara apo të referuara në këtë marrëveshje, shumën prej euro 12,700,000.

Sipas Seksioni 2.02. Terma të tjerë financiarë të huas:

- a) Shuma minimale për tërheqje do të jetë euro 100,000.
- b) Shuma minimale për parapagim do të jetë euro 1,000,000.
- c) Shuma minimale për anulim do të jetë euro 1,000,000.
- d) Datat e pagesës së interesit do të jenë 25 mars dhe 25 shtator të çdo viti.

Huamarrësi do ta shlyejë huan në 26 këste të barabarta gjashtëmujore (ose sa më të barabarta që të jetë e mundur) në secilën datë të pagesës së interesit, duke qenë data e parë e pagesës së huas në datën e pagesës së interesit menjëherë pas përvjetorit të dytë të kësaj marrëveshje.

Nga auditimi rezulton se Ministria e Financave ka filluar pagesën e principalit në vitin 2015 dhe të interesit në vitin 2013.

Pagesat e kryera për principalin nga ana e Ministrisë së Financave deri në datë 31.12.2024 është në shumën 8,531,111.54 euro.

Pagesat e kryera për interesin nga ana e Ministrisë së Financave deri në datë 31.12.2024 është në shumën 949,029.11 euro.

Huamarrësi nuk e tërheq të gjithë shumën e huas përpara datës së parë të pagesës së huas të përcaktuar në këtë seksion 2.02 (e); dhe

ii) Banka, me kërkesë të Huamarrësit, e shtyn datën e fundit të disponueshmërisë të përcaktuar në seksionin 2.02 (f) më poshtë për në një datë e cila bie pas datës së parë të pagesës së huas, atëherë shuma e çdo tërheqjeje të bërë në datën apo pas datës së parë të pagesës së huas do të shpërndahet për t’u ripaguar në shuma të barabarta nëpër këstet e tjera të cilat bien pas datës së kësaj tërheqjeje (duke rregulluar Banka shumat e caktuara në këtë mënyrë si të jetë e nevojshme për të përfutur numra të plotë në çdo rast). Banka, kohë pas kohe, do të njoftojë Huamarrësin për këto shpërndarje.

f) Data e fundit e disponueshmërisë do të jetë 31 dhjetor 2016 ose një datë e mëvonshme siç mund të bihet dakord ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit.

g) Huaja i nënshtrohet një norme të luhatshme (variabël) interesi në përputhje me seksionin 3.04(b) të termave dhe kushteve standarde.

Përdorimi i kredisë:

Kategoria	Shuma e huas e caktuar në monedhën e huas	Përqindja e shpenzimeve për t’u financuar
1. Mallra dhe punime për pjesën A	euro 10,000,000	100 % e vlerës së kontratës, duke përjashtuar çfarëdo takse

2. Mallra dhe punime për pjesën B	euro 2,573,000	100 % e vlerës së kontratës, duke përjashtuar çfarëdo takse
3. Komisioni fillim-mbarim	euro 127,000	100%
Totali	euro 12,700,000	100%

Për sa më sipër rezulton se me shkresën me datë 21.12.2016 BERZH ka përcjell shkresën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kredisë deri në datë 31.12.2018.

Me amendimin nr. 1 datë 28.09.2018 është zgjeruar koncepti i përdorimit të kredisë për pjesën e mbetur pa shpenzuar nga kredisë, si dhe afatin e vlefshmërisë së saj deri në 31.12.2021. Ky amendim është ratifikuar me ligjin nr. 88/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, të marrëveshjes së huas, të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr. 103/2013”

Kategoria	Shuma e huas, e alokuar në monedhën e kredisë	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1. Mallrat dhe punimet për pjesën A	5,619,575 euro	100% e vlerës së kontratës, duke përjashtuar çdo taksë
2. Mallrat dhe punimet për pjesën B	825,201 euro	100% e vlerës së kontratës, duke përjashtuar çdo taksë
3. Mallrat dhe punimet për pjesën C	6,128,224 euro	100% e mallrave dhe e punimeve për pjesën C, duke përjashtuar taksat
4. Komisioni <i>Front - End</i>	127,000 euro	100%
TOTALI	12,700,000 euro	100%

h) Norma e tarifës së angazhimit do të jetë 0.5 % në vit për t’u llogaritur dhe e pagueshme në përputhje me seksionin 3.05 të termave dhe kushteve standarde.

i) Norma e komisionit fillim-mbarim do të jetë 1 % e shumës maksimale të principalit të huas (euro 127,000) dhe e pagueshme në përputhje me seksionin 3.05 të termave dhe kushteve standarde.

j) Tarifa e parapagimit do të jetë 0.125 % e shumës së principalit të huas që do parapaguhet, e pagueshme në përputhje me seksionin 3.07 të termave dhe kushteve standarde.

k) Tarifa e anulimit do të jetë 0.125 % për t’u përllogaritur dhe e pagueshme në përputhje me seksionin 3.08 të termave dhe kushteve standarde.

l) Norma e interesit të shkaktuar nga paafësia paguese do të jetë 2 % në vit plus marzhin, për t’u përllogaritur dhe e pagueshme në përputhje me seksionin 3.09 të termave dhe kushteve standarde.

m) Pagesa e principalit, interesit dhe detyrimeve të huas do të kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të termave dhe kushteve standarde dhe sipas seksionit 3.11 të termave dhe kushteve standarde.

Seksioni 2.03. Tërheqjet

a) Shuma e disponueshme mund të tërhiqet herë pas here në përputhje me dispozitat e programit 2 për të financuar:

- shpenzime të bëra (ose për t’u bërë nëse banka bie dakord) në lidhje me kosto të arsyeshme për mallra dhe punime të nevojshme për projektin; dhe
- për komisionin fillim-mbarim.

Ecuria e disbursimeve në vite:

Viti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Totali
Shuma	127,000	2,203,636	1,922,421	833,081	1,198,415	912,304	969,844	2,853,212	1,673,513	12,693,426

Seksioni 2.04. Përfaqësuesi i autorizuar për tërheqje. Ministri i Financave i huamarrësit caktohet si përfaqësuesi i autorizuar i huamarrësit për qëllim të marrjes së ndonjë veprimi të kërkuar apo të lejuar sipas dispozitave të seksionit 2.03 (a) dhe sipas dispozitave të seksioneve 3.01 dhe 3.02 të kushteve dhe termave standarde.

Sipas nenit 3 “zbatimi i projektit”, pika 7

7. Mbajtjen e procedurave, regjistrave, raporteve dhe llogarive, përgatitjen, kontrollin financiar (auditimin) dhe paraqitjen ndaj bankës të deklaratave financiare, si edhe dhënien ndaj bankës të çdo informacioni me rëndësi në lidhje me projektin ose operacionet e entitetit të projektit;

Sipas nenit 5 “efektiviteti”, seksioni 5.01. kushtet pararendëse të efektivitetit

iv) llogaritë e projektit do të jenë hapur në një bankë tregtare të pranueshme për bankën, në përputhje me marrëveshjen e projektit.

Nga auditimi rezulton se nuk është vepruar nëpërmjet një llogarie të hapur në bankë tregtare por është vepruar me pagesa direkt nga EBRD tek kontraktori.

Realizimi i komponentëve të projektit:

Kredi EBRD (EUR 12,700,000)	Vlera totale e kontratës	Vlera e disbursuar deri në 31.12.2021	Vlera e padisbursuar 31.12.2021	Vlera e Disbursuar në %
Kredia EBRD (EUR, 12,700,000)	12,700,000.00	12,693,426.34	6,573.66	99.9%
Kategoria 1. Mallra dhe shërbime Pjesa A	5,619,575.00	5,613,000.43	6,574.57	100%
Kategoria 2. Mallra dhe shërbime Pjesa B	825,201.00	825,201.91	(0.91)	100%
Kategoria 3. Mallra dhe shërbime Pjesa C	6,128,224.00	6,128,224.00	-	100%
Kategoria 4. Komisione	127,000.00	127,000.00	-	100%
Vlera e mbetur pas realizimit të kontratës	12,700,000.00	12,693,426.34	6,573.66	

Pagesa e TVSH:

Bazuar në marrëveshje TVSH e projektit do të trajtohet si kosto lokale dhe do të rimbursohet nga KESH Sha:

	Nr Faturës	Vlera pa TVSH	TVSH	Vlera Totale
Viti 2018	01/26.12.2018	77,497,674.66	15,499,534.93	92,997,209.59
Viti 2019	07/01.08.2019	12,076,276.09	2,415,255.22	14,491,531.30
	08/01.08.2019	14,827,853.29	2,965,570.66	17,793,423.94
	11/01.10.2019	19,736,473.13	3,947,294.63	23,683,767.76
	13/01.10.2019	27,451,915.25	5,490,383.05	32,942,298.30
	15/13.11.2019	20,557,916.16	4,111,583.23	24,669,499.39
Viti 2020	24/07.01.2020	14,500,505.65	2,900,101.13	17,400,606.78
	27/04.02.2020	31,142,420.00	6,228,484.00	37,370,904.00

	31/03.03.2020	27,902,967.80	5,580,593.56	33,483,561.35
	43/06.05.2020	34,016,682.57	6,803,336.51	40,820,019.09
	44/06.05.2020	18,035,701.06	3,607,140.21	21,642,841.27
	03/30.07.2020	15,952,613.55	3,190,522.71	19,143,136.26
	04/30.07.2020	23,377,658.66	4,675,531.73	28,053,190.40
	07/30.07.2020	8,392,651.97	1,678,530.39	10,071,182.37
	09/01.10.2020	12,581,823.35	2,516,364.67	15,098,188.02
	10/01.10.2020	32,637,076.17	6,527,415.23	39,164,491.40
	11/16.10.2020	21,768,581.91	4,353,716.38	26,122,298.29
	16/05.11.2020	20,291,237.02	4,058,247.40	24,349,484.42
	19/31.12.2020	22,699,540.05	4,539,908.01	27,239,448.06
Viti 2021	22/11.01.2021	8,384,365.64	1,676,873.13	10,061,238.77
	24/01.04.2021	8,290,652.13	1,658,130.43	9,948,782.56
	26/15.04.2021	7,279,211.76	1,455,842.35	8,735,054.11
	27/15.04.2021	6,492,669.79	1,298,533.96	7,791,203.75
	35/31.05.2021	5,084,594.58	1,016,918.92	6,101,513.49
	36/07.06.2021	28,837,386.93	5,767,477.39	34,604,864.32
	02/12.07.2021	15,241,690.50	3,048,338.10	18,290,028.59
	07/19.08.2021	14,995,602.12	2,999,120.42	17,994,722.55
	43/08.09.2021	14,856,835.59	2,971,367.12	17,828,202.71
	62/27.10.2021	22,510,180.88	4,502,036.18	27,012,217.06
	82/10.11.2021	7,252,610.78	1,450,522.16	8,703,132.93
	87/10.11.2021	6,468,943.12	1,293,788.62	7,762,731.75
	103/20.12.2021	13,132,762.08	2,626,552.42	15,759,314.49
	104/20.12.2021	5,390,314.78	1,078,062.96	6,468,377.73
	105/20.12.2021	5,053,498.01	1,010,699.60	6,064,197.61

Nga auditimi i praktikave të TVSH u shqyrtuan 10 prej tyre, konkretisht:

Me shkresën nr. 1058/1 prot., datë 07.04.2020 është kërkuar rimbursimi i TVSH-së në favor të C. A.S. (Degë e Shoqërisë së Huaj), me vlerën 2,900,101 Lekë. Bashkëngjitur gjenden:

-Fatura tatimore nr. 24, datë 07.01.2019 me vlerë 2,900,101 Euro;

-Fatura komerciale me dy skedule: skeduli Nr.3, datë 19.11.2019 me vlerë 14,651.00 Euro dhe skeduli nr.4 datë 19.11.2019 me vlerë 131,966.70 Euro;

-Kërkesa për disbursim drejtuar EBRD-së me datë 31.12.2019.

Me shkresën nr. 2371/2 prot., datë 25.09.2020 është kërkuar rimbursimi i TVSH-së në favor të C. A.S me vlerën 3,190,522.70 Lekë. Bashkëngjitur gjenden:

-Fatura tatimore nr. 03, datë 30.07.2020 me vlerë 3190522,71 Euro;

-Fatura komerciale me datë 09.05.2020 dhe me vlerë 160,968.41 Euro.

Me shkresën nr. 2002/2 prot., datë 10.11.2020 është kërkuar financimi i llogarisë për TVSH për shumën 2,516,364.67 Lekë, në favor të Kompanisë C. A.S. Bashkëngjitur gjenden:

-Fatura tatimore nr. 09 datë 01.10.2020, e kompanisë C. A.S., me vlerë 2516364,67 Euro;

-Pagesa e kryer nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, EBRD 43125, datë 24.09.2020; dhe

-Kërkesa për disbursim drejtuar EBRD-së me datë 11.08.2020.

Me shkresën nr. 187/3 prot., datë 22.02.2021 është kërkuar financimi i llogarisë për TVSH për shumën 1,676,873.13 Lekë, në favor të Kompanisë C. A.S. Bashkëngjitur gjenden:

-Fatura tatimore nr. 22 datë 11.01.2021, të kompanisë C. A.S., me vlerë 2516364,67 Euro;

-Pagesa e kryer nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, EBRD 43125, datë 29.01.2021; dhe

-Fatura komerciale me datë 01.01.2021 dhe me vlerë 84,752.206 Euro.

Me shkresën nr. 2973/1 prot., datë 23.09.2021 është kërkuar financimi i llogarisë për TVSH për shumën 1,016,919 Lekë në favor të C. A.S. Bashkëngjitur gjenden:

-Fatura tatimore Nr. 35, datë 31.05.2021 e Kompanisë C. A.S., me vlerë 1016918,91 Euro;
-Fatura komerciale me datë 30.04.2021 dhe me vlerë 51,651.707 Euro; dhe
-Pagesa e kryer nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, EBRD 43125 datë 21.06.2021.

Me shkresën nr. 84/15 prot., datë 02.03.2022 është kërkuar financimi i llogarisë për TVSH për shumën 1,010,700 Lekë në favor të C. A.S. Bashkëngjitur gjenden:

-Fatura tatimore elektronike nr. 105/2021 datë 20.12.2021, e kompanisë C. A.S., me vlerë 50208,62 Euro;

-Faturën komerciale me datë 31.10.2021 dhe me vlerë 217,073.686 Euro; dhe

-Pagesën e kryer nga EBRD 43125 datë 14.12.2021.

Me shkresën nr. 84/7 prot., datë 28.02.2022 është kërkuar financimi i llogarisë për TVSH për shumën 2,626,552 Lekë, në favor të Kompanisë C. A.S. Bashkëngjitur gjenden:

-Fatura tatimore elektronike nr. 103/2021 datë 20.12.2021, e kompanisë C. A.S., me vlerë 130479,50 Euro;

-Faturën komerciale me datë 06.04.2021 dhe me vlerë 108,732.92 Euro; dhe

-Pagesën e kryer nga EBRD 43125 me datë 16.12.2021.

Me shkresën nr. 933/1 prot., datë 21.02.2022 është kërkuar rimbursim i TVSH për shumën 1,450,522.16 Lekë, në favor të Kompanisë C. A.S. Bashkëngjitur gjenden:

-Fatura tatimore elektronike Nr. 82/2021 datë 10.11.2021, e kompanisë C. A.S., me vlerë 70935,96 Euro;

-Faturën komerciale me datë 06.04.2021 dhe me vlerë 59,113.30 Euro;

Me shkresën nr. 933/3 prot., datë 21.02.2022 është kërkuar rimbursim i TVSH për shumën 1,283,788.13 Lekë, në favor të Kompanisë C. A.S. Bashkëngjitur gjenden:

-Fatura tatimore elektronike nr. 87/2021 datë 10.11.2021, e kompanisë C. A.S., me vlerë 63271,10 Euro;

-Faturën komerciale me datë 06.04.2021 dhe me vlerë 52,725.92 Euro;

Me shkresën nr 84/13 prot., datë 02.03.2022 është kërkuar rimbursim i TVSH për shumën 1,078,063 Lekë, në favor të Kompanisë C. A.S. Bashkëngjitur gjenden:

-Fatura tatimore elektronike Nr. 104/2021 datë 20.12.2021, e kompanisë C. A.S., me vlerë 53555,04 Euro;

-Fatura komerciale me datë 30.09.2021 dhe me vlerë 49,588.00 Euro;

Nga auditimi konstatohet se KESH Sha ka kryer rimbursimin e TVSH bazuar në faturën me TVSH pa hartuar dhe zbatuar filtra kontrolli nëse realisht kontraktori e ka kryer pagesën e TVSH.

Pagesat e kryer nga Ministria e Financave:

Referuar të dhënave të marra nga Ministria e Financave me e-mailin e datës 01.04.2024 ku janë pasqyruar të gjitha pagesat e kryera nga MF për këtë projekt:

	Principal	Interes	Komisione
2013	0	0	127,000.00
2014	0	3,382.24	99,739.79
2015	241,625.29	26,502.42	52,111.39
2016	391,696.04	44,735.90	40,979.82
2017	501,598.92	50,112.22	35,330.58
2018	514,963.20	50,902.68	32,522.76
2019	629,356.91	53,516.77	28,456.33
2020	904,238.12	66,037.37	18,906.78
2021	1,185,318.52	78,146.52	7,969.49

2022	1,387,438.18	79,408.50	607.58
2023	1,387,438.18	232,312.63	0
2024	1,387,438.18	263,971.86	0
Shuma	8,531,111.54	949,029.11	443,624.52

Nga auditimi rezulton se për shkak të zgjatjes së projektit dhe mos disbursimit në kohë të fondeve të vendosura në dispozicion MF ka paguar ndaj EBRD vlerën prej 316,624.52 euro, e cila është kosto shtesë për MF dhe KESH sha.

Marrëveshja e nënhuasë:

Në bazë të marrëveshjes së huasë është lidhur Marrëveshje e Nënhuasë midis MF dhe KESH SHA ku detyrimet financiare të parashikuara në marrëveshje i kanë kaluar KESH SHA ku janë parashikuar edhe detyrimet përkatëse.

Bazuar në seksionet 3.03 dhe 3.04 detyrimet i kanë kaluar KESH SHA.

Nga auditimi rezulton se të vetmet pagesa që KESH SHA ka kryer ndaj MF janë:

- Interes viti 2014 – 3.382,24 EUR
- Komisione 2014 – 99.739,79 EUR

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me seksionet 3.03 dhe 3.04 të Marrëveshjes së Nënhuasë si dhe kanë ngarkuar buxhetin e shtetit me kosto ekstra dhe detyrime të cilat duhet ti mbulojë KESH SHA.

2.4 Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të prokurimit të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacioni shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtim, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës.

Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (huamarrësi) dhe BERZH-i kanë lidhur një marrëveshje huaje të datës 31 dhjetor 2012 e ratifikuar me Ligjin nr. 103/2013, (Për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit), në përputhje me të cilën BERZH-i ka rënë dakord t'i japë Huamarrësit një hua që nuk tejkalon 12,700,000 euro, për qëllimet e Projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit. Huamarrësi, nëpërmjet Njësisë së Projektit, ka zbatuar Projektin, duke arritur kursimet e huas në shumën totale prej 6,128,224 eurosh.

Më datë 21.12.2016 EBRD ka njoftuar Ministrinë e Financave për shtyrjen e afatit të disponibilitetit të shumës së mbetur pas kërkesës së marrësit deri më 31.12.2018.

Në raportet e projektit të Bankës Botërore për Sigurinë e Digave, me nr. P110481, filluar më datë 31.12.2013 dhe përfunduar më datë 31.12.2016, është evidentuar nevoja për rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC-it të Fierzës dhe Komanit.

Nga korrespondenca e mbajtur nga drejtuesi i Njësisë së Menaxhimit të Projekteve, konstatohet se pas takimit të bërë më datë 31.03.2016, janë përgatitur nga KESH specifikimet teknike në versionin përfundimtar për procedurën e prokurimit të portave të shkarkimit dhe dërguar përfaqësuesit të Bankës Botërore për vlerësim dhe aprovim.

Më datë 27.06.2016, përfaqësuesi i Bankës Botërore i ka dërguar një shkresë Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës, për dijeni dhe Ministrit të Financave, ku parashtron urgjencën e rehabilitimit të portave të shkarkimit, bashkëpunimin intensiv me KESH SHA për finalizimin e plotësimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit si dhe kërkon bashkëpunimin e të gjithë institucioneve për ti kompletuar në shtator të 2016.

Procedura e prokurimit është publikuar në portalin e prokurimeve të Kombeve të Bashkuara me nr. Reference WB3079-07/16, nga Banka Botërore më datë 12.07.2016 me afat deri më

15.09.2016. KESH SHA ka publikuar në gazetat TEMA dhe DITA procedurën më datë 14.08.2016.

Në këtë njoftim shpjegohet se Qeveria e Shqipërisë ka aplikuar për financim shtesë prej Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim kundrejt Projektit të Sigurisë së Digave. Qëllimi është që një pjesë të këtij fondi të përdoret për pagesa për kontratën për Rehabilitimin e Portave të Shkarkimit e të Remontit të HEC-eve Fierzë, Koman dhe demontimin dhe rindërtimin e dhomës së portës në Portën e shkarkimit Nr. 3 në Fierzë. Korporata Elektroenergjitike Shqiptare do të vlerësojë ofertat për kontratën sa më sipër.

Me Urdhrin nr. 41, datë 19.09.2016, nr. 7801 Prot., administratori i KESH SHA, A. H. ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave për kontraktimin e operatorit për rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe remontit të HEC Fierzë dhe HEC Koman, i përbërë nga T. H. kryetar dhe F. B., Z. Sh., A. G. dhe V. H. anëtarë.

Urdhri është bazuar në Ligjin nr. 40/2012 datë 12.04.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financim shtesë të projektit (Siguria e Digave) ” me qëllim zgjedhjen e një kontraktori për kryerjen e Rehabilitimit të Portave të Shkarkimit dhe të Remontit të HEC Fierzë dhe HEC Koman. Procedurat e prokurimit janë kryer në përputhje me udhëzuesit e IBRD.

Në shtator të 2017, pas kalimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave datës 15.09.2016, komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga T. H. kryetar, F. B., Z. Sh., A. G. dhe V. H. anëtarë kanë hapur zarfat e ofertave, ku kanë marrë pjesë R.doo, Sllovenia me ofertë 9,315,153 euro, C. AS, Turqia, me ofertë 12,340,903 euro, A. H. GmbH, Austria, me ofertë 20,658,464 euro, C. I. SpA, Italia, me ofertë 15,901,180 euro dhe S. K.. Ltd., Kinë, me ofertë 11,057,560 euro.

Në përmbledhje, Komisioni i Vlerësimit të KESH-it ka konkluduar se: -S. K.. Ltd., Kinë, me ofertë 11,057,560 euro, është përjashtuar nga IBRD, duke ju referuar çështjes me nr. 372, dhe oferta e paraqitur nga C. AS, Turqi është teknikisht në përputhje me kërkesat e ofertës si dhe oferta më e ulët duke e shpallur fituese.

Më date 10.10.2017, administratori i KESH sha., i është drejtuar shoqërisë C. A.S., me shkresën nr. 5126 Prot., për ta njoftuar se oferta e tyre në vlerën 12.340.903 euro për dy lotet është pranuar, dhe duhet të vënë në dispozicion siguracionet sipas kërkesave të parashikuara.

Më datë 01.12.2017, Ministri i Financave me shkresën me nr. 17494 Prot., i ka kërkuar Bankës Botërore akordimin e një financimi shtesë në vlerën e 12,000,000 euro, në kuadër të marrëveshjes së mëparshme për Sigurinë e Digave.

Më datë 07.06.2018 është firmosur kontrata me nr. DSP-IDA 05-16, pa numër protokollit, ndërmjet KESH, nënshkruar nga administratori i KESH A. H. dhe shoqërisë fituese C. A.S., me 2 lote. Lot 1: Prishja dhe rindërtimi i portës së derdhjes 3 dhe rehabilitimi i portave të derdhjes dhe Stoplogët e HEC-it të Fierzës dhe Loti 2: Rehabilitimi i portave të shkarkimit dhe ndalesave të HEC-it të Komanit. Kontrata ka dhe tetë anekse me specifikime.

Në artikullin 3.1, Hyrja në fuqi përcaktohet se kjo kontratë hyn në fuqi fondet e nevojshme për të financuar projektin do të jenë mundshme nga Qeveria e Shqipërisë ndërmjet një kredie me IBRD.

Më datë 21.06.2018 është pranuar marrëveshja ndërmjet IBRD dhe KESH për huanë me nr. 8862-AL në lidhje me implementimin e projektit, e firmosur nga përfaqësuesi i KESH administratori A. H. dhe përfaqësuesi i IBRD M. S.. Kontrata nuk ka numër protokollit të KESH.

Më datë 20.09.2018, me ligjin nr. 61/2018, Kuvendi i Shqipërisë ka ratifikuar marrëveshjen e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe

Zhvillim (IBRD), pë shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, për vlerën 12,000,000 euro.

Në skedulën nr.1, Përshkrimi i Projektit, pjesa e parë konsiston në investime në infrastrukturën e sigurisë së digave, pjesa b) në rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe të portave segmente të sigurisë në Hidrocentralin e Komanit. Në sektorin III, të prokurimit janë përcaktuar modalitetet dhe udhëzimet e prokurimit si kontratat e lidhura në bazë të tenderimit konkurrues ndërkombëtar.

Në shtojcën e ligjit, pikat 5-6 përcaktohet se “bashkë-financues” është Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe shuma është 6,100,000 euro.

Më datë 29.09.2018, Huamarrësi dhe BERZH-i kanë ndryshuar Marrëveshjen Fillestare, me qëllim që të zgjerojnë përkufizimin e Projektit, në mënyrë që të përfshijë edhe rehabilitimin e portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit duke mundësuar që kursimet në vlerën 6,128,224 euro, të aplikohen për financimin e elementeve të reja të Projektit. Marrëveshja Ndryshuese është ratifikuar me Ligjin nr. 88/2018 dhe miratuar më datë 22.11.2018.

Më datë 19.10.2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 12879/6 Prot., i ka dërguar MIE dhe KESH kopjen e dokumentit ndryshues të marrëveshjes së huasë me BERZH. Me Urdhrin Administrativ, drejtuesi i Njesisë së Menaxhimit të Projekteve F. B., ka njoftuar shoqërinë fituese C. A.S., se KESH njih si datë fillimi të projektit, datën 01.02.2019, bazuar në përcaktimin e datës efektive dhe në nenin 3.2 të kontratës së marrëveshjes.

Nga dokumentet e vëna në dispozicion konstatohet se nga përfaqësuesit e KESH, administratori dhe drejtuesi i Njesisë së Menaxhimit të Projekteve është iniciuar procesi i prokurimit të procedurës me objekt: Lot 1: Prishja dhe rindërtimi i portës së derdhjes 3 dhe rehabilitimi i portave të derdhjes dhe Stoplogët e HEC-it të Fierzës dhe Loti 2: Rehabilitimi i portave të shkarkimit dhe ndalesave të HEC-it të Komanit, për llogari të IBRD pa disponuar financime të aprovuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të pa ratifikuara nga Parlamenti.

Administratori i KESH A. H. ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave me qëllim zgjedhjen e një kontraktori për kryerjen e Rehabilitimit të Portave të Shkarkimit dhe të Remontit të HEC Fierzë dhe HEC Koman, të procedurës së prokurimit bazuar në Ligjin nr. 40/2012 datë 12.04.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financim shtesë të projektit (Siguria e Digave)”, ligj i cili nuk ka si objekt procedurën e prokurimit më sipër.

Administratori i KESH A. H., pa pasur autorizim dhe miratim nga organet vendimmarrëse si Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Ortakëve, në lidhje me investimin që do të kryhej, më datë 07.06.2018 ka firmosur kontratën me nr. DSP-IDA 05-16, pa numër protokolli, ndërmjet KESH dhe shoqërisë fituese C. A.S.

Kontrata gjithashtu është lidhur pa u aprovuar dhe ratifikuar financimi nga Ministria e Financave dhe Parlamenti i Shqipërisë, të kryera me Ligjin 61/2018, datë 20.09.2018 për IBRD dhe Ligjin 88/2018 dhe miratuar më datë 22.11.2018, për EBRD.

Sa më sipër është në kundërshtim me statutin e shoqërisë KESH SHA, pika 11, “*Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës (iv) miraton angazhimet për krijimin e detyrimeve të reja financiare, përpara se këto të paraqiten tek Asambleja e Përgjithshme për miratimin përfundimtar; (v) miraton marrjen e huave afatmesme dhe afatgjata përpara se këto të paraqiten tek Asambleja e Përgjithshme për miratimin përfundimtar (vi) Miraton marrjen e huave afatshkurtra me vlerë më të madhe se 50 milion lekë. (vi) miraton hapjen e aktiviteteve të reja, shoqërive të reja si dhe pjesëmarrjen apo investimet në kapitalin e shoqërive të tjera; si dhe pika (i) analizon, jep rekomandime dhe miraton strategjinë e Shoqërisë, përfshirë planin shume vjeçar tregtar dhe*

te investimeve (si dhe programin ekonomik financiar), përpara se të paraqiten në Asamblenë e Përgjithshme për miratimin përfundimtar;”.

Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 26 të Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku caktohet: “Procedurat e negociimit dhe miratimit të marrëveshjeve, instrumenteve për huat shtetërore dhe garancitë shtetërore të huas. Procedurat e negociimit dhe miratimit të marrëveshjeve, instrumenteve për huat shtetërore dhe garancitë shtetërore të huas Ministria e Financave mban kontakte zyrtare të drejtpërdrejta me kreditorët për sigurimin e financimeve nëpërmjet kredive. Në rastet kur merret hua nga kreditorë privatë, përzgjedhja e kreditorit bëhet nëpërmjet procedurave të përzgjedhjes, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministri përgjegjës për financat negocion dhe vendos për kushtet thelbësore të kontratave të huas në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave.”

Për sa më sipër mban përgjegjësi ish administratori i KESH SHA, z. A. H.

2.5 Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra, shërbime dhe konsulencë

Drejtori i njësisë HEC K. P., i bazuar në një autorizim të drejtorit të Departamentit të Gjenerimit të KESH SHA, T. B. ka ngritur komisionin për marrjen në dorëzim.

Në lidhje me procesin e dorëzimit të punëve civile dhe pajisjeve u konstatua se procesi i marrjes në dorëzim është kryer nga Njësia e Menaxhimit të Projekteve sipas kërkesave të kontratës por nga ana e KESH SHA procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve nuk është në përputhje me nenet dhe pikat 42, 43 “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Referuar metodologjisë së punimeve të realizuar u konstatua se është devijuar (tharë apo bllokuar) tuneli i shkarkimit të ujerave, me qëllim riparimet dhe vendosjen strukturave të portave (Saldime, bashkime, montime etj.) dhe më pas është mbuluar nga uji. Pas riparimeve të strukturave të portave, kontrollet apo verifikimet realizoheshin vetëm me polubar, sipas specifikimeve teknike dhe dokumenteve të tenderit.

Në lidhje me pjesën e pagesave:

Data	Përshkrimi	Disbursimet
		EUR
2018		
05.12.2018	10% Parapagesë C. A.S.	631,654.37
	Total Viti 2018	631,654.37
	Totali i disbursuar 31.12.2018	631,654.37
2019		
23.07.2019	C. A.S. Design shërbim e instalim	221,451.39
18.09.2019	C. A.S. Instalim	161,588.94
26.09.2019	C. A.S. mallra dhe instalime	357,653.62
29.11.2019	C. A.S. mallra dhe instalime	229,150.51
	Total Viti 2019	969,844.46
	Totali i disbursuar 31.12.2019	1,601,498.83
16/01/2020	C. A.S. mallra dhe instalime	536,979.56
18/02/2020	C. A.S. mallra dhe instalime	227,333.94
06/05/2020	C. A.S. mallra dhe instalime	610,430.69

01/07/2020	C. A.S. mallra dhe instalime	395,453.74
10/07/2020	C. A.S.5% Certifikata e plotësimit të pajisjeve stop-log	85,610.87
21/09/2020	C. A.S. mallra dhe instalime	364,521.55
16/10/2020	C. A.S. mallra dhe instalime	206,064.51
04/11/2020	C. A.S. mallra dhe instalime	163,863.66
24/11/2020	C. A.S. mallra dhe instalime	262,953.76
	Total Viti 2020	2,853,212.28
	Totali i disbursuar 31.12.2020	4,454,711.11
2021		
05/01/2021	C. A.S. mallra dhe instalime IPC 17	103,324.80
21/06/2021	C. A.S. mallra dhe instalime IPC 18&19/Plotësimi SL3 RG4	305,145.69
04/08/2021	C. A.S. mallra dhe instalime IPC 20	234,335.99
04/08/2021	C. A.S. mallra dhe instalime IPC 21	124,391.50
17/09/2021	C. A.S. mallra dhe instalime IPC 22	141,314.31
18/10/2021	C. A.S. mallra dhe instalime IPC 23	170,112.73
10/11/2021	C. A.S. mallra dhe instalime IPC 24	210,582.15
14/12/2021	C. A.S. mallra dhe instalime IPC 25	218,288.24
28/12/2021	C. A.S. Plotësimi i certifikatës RG3	109,892.04
28/12/2021	C. A.S. Certifikata e operimit parçiale	56,125.53
	Totali deri në dhjetor 2021	1,673,512.98
	Totali i disbursuar 30.09.2021	6,128,224.09

Me shkresën nr. 4871 prot., datë 13.09.2018 “Miratimi i parapagesës ndaj C. A.S.” në vlerën 631,654.37 euro për faturat:

- Aplikimi për disbursim datë 12.09.2018
- Fatura e Parapagimit në vlerën 06.06.2018
- Garancia e parapagimit datë 24.10.2017
- Konfirmimi nga banka datë 24.10.2017

Bazuar në Kontratën datë 07.06.2018 lidhur midis KESH Sha dhe C. A.S., neni 3, pikat 3.1, 3.2, dhe 3.3, ku citohet:

“3.1 Kjo kontratë hyn në fuqi pasi të jenë vendosur në dispozicion fondet e nevojshme për financimin e punës nga Qeveria Shqiptare nëpërmjet bërjes efektive të marrëveshjes së huasë me IBRD për shtesën e dytë të financimit për Projektin e Sigurisë së Digave.

3.2 Data efektive

Data efektive nga e cila do të llogaritet koha për përfundimin e objekteve është data kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtëm:

a) Kjo marrëveshje kontrate është ekzekutuar plotësisht për llogari të punëdhënësit dhe kontraktorit;

b) Kontraktori i ka paraqitur punëdhënësit garancinë për sigurimin e kontratës dhe garancinë për pagesën paradhënie;

c) Punëdhënësi i ka paguar kontraktorit paradhënien.

Secila palë do të bëjë përpjekjet e saj me të mira për të përmbushur kushtet e mësipërme për të cilat është përgjegjëse, sa më shpejt të jetë e mundur.

3.3 Nëse kushte e listuar nen 3.1 nuk janë plotësuar brenda 4 muajve nga data e njoftimit të kësaj kontrate, për arsye që nuk i atribuohen Kontraktorit, palët do të diskutojnë dhe bien

dakort për një rregullim të drejtë të çmimit të kontratës dhe kohën e përfundimit dhe /ose kushte të tjera përkatëse të kontratës.”

Shkresa datë 27.11.2018 e EBRD njofton se datë efektive e Amendimit të Marrëveshjes do të jetë data 27.11.2018.

Shkresa datë 29.11.2018 e Bankës Botërore njofton se datë efektive e Amendimit të Marrëveshjes me IBRD do të jetë data 29.11.2018.

Disbursimi i parapagimit është kryer 05.12.2018.

Më datë 05.12.2018, KESH ka përcjellë tek BERZH praktikën për disbursimin e 10 % parapagesë sipas kushteve të kontratës kundrejt faturës dhe një garancie të pakthyeshme për të njëjtën vlerë.

Në kontratë përcaktohet se procedurat për pagesë janë si vijon:

Kontraktori do ti dorëzojë faturën dhe garancinë e pakthyeshme KESH-it, i cili do verifikojë dhe aprovojë dokumentet dhe do të ja kalojë Bankës për pagesë. Fatura e kontraktorit do të siglohet nga Menaxheri i Projektit dhe garancia në favor të KESH.

Në seksionin e tretë të kontratës, kushtet e veçanta përcaktohet, gjuha e kontratës është anglishtja dhe kontrata do të interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Aneksi 1, Kushtet dhe procedurat e pagesave përcakton se kontraktori do ti dërgojë dokumentet e përmendura në kushtet e pagesave punëdhënësit (KESH). KESH (Employer) do të verifikojë dhe aprovojë dokumentet dhe do të ja kalojë Bankës e cila do të kryej pagesat direkt tek kontraktori.

Për sa më sipër është pranuar një dokument i lëshuar nga kontraktori (advance payment bill), në një datë kur kontrata mes palëve nuk ishte e lidhur. Në kontratë emërtohet dokumenti (invoice), faturë e cila përpilohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. i ndryshuar, nenet 49-50.

Me shkresën nr. 3616/1, datë 04/09/2019 “Miratim Pagese në favor të C. A.S.” në vlerën 161,588.94 euro për faturat:

- Faturën T19/126 për Tabelën 4, Lot 2 Komani;
- Deklaratën për pagesën IPC 2 për periudhën 1 Maj-30 Qershor 2019;
- Aplikimi sipas formularëve standart të EBRD-së.

Me shkresën nr. 6068/1, datë 31/12/2019 “Miratim Pagese në favor të C. A.S.” në vlerën 281,5488.22 euro për faturat:

- Faturat T19/199 për Tabelën 1, dhe T19/200 për Tabelën 3 dhe T19/2011 për Tabelën 4, Lot 2 Komani;
- Deklaratën për pagesën IPC 5 për periudhën 1-31 Tetor 2019.
- Aplikimi sipas formularëve standart të EBRD-së.

Me shkresën nr. 4365/2 datë 21/11/2019 “Miratim Pagese në favor të C. A.S.” në vlerën 229,150.51 euro për faturat:

- Faturën T19/177 për Tabelën 4, dhe T 19/176 për Tabelën 1, Lot 2 Komani;
- Deklaratën për pagesën IPC 4 për periudhën 1-30 Shtator 2019;
- Aplikimi sipas formularëve standard të EBRD-së.

Me shkresën nr. 6069/1, datë 31/12/2019 “Miratim Pagese në favor të C. A.S.” në vlerën 255.391.34 euro për faturat:

- Faturë T19/2012 sipas Tabelës 4, Shërbime Instalimi dhe të tjera, Lot 2 Komani;
- Deklaratën për pagesën IPC 6 për periudhën 1-30 Nëntor 2019;
- Aplikimi sipas formularëve standard të EBRD-së.

Me shkresën nr. 489, datë 06/02/2020 “Miratim Pagese në favor të C. A.S.” në vlerën 227,333.94 euro për faturat:

- Faturë T20/009 sipas Tabelës 4, Shërbime Instalimi dhe të tjera, Lot 2 Komani;
- Deklaratën për pagesën IPC, 7 për periudhën 1 Dhjetor 2019-15 Janar 2020;
- Aplikimi sipas formularëve standard të EBRD-së.

Me shkresën nr. 865/1 datë 27/04/2022 “Miratim Pagese në favor të C. A.S.” në vlerën 366,543.55 euro për faturat:

- Faturë T20/039 sipas Tabelës 1, Mallra të furnizuara nga jashtë;
- Faturë T20/040 sipas Tabelës 4, Shërbime Instalimi dhe të tjera, Lot 2 Komani;
- Deklaratën për pagesën IPC 8 për periudhën 16 Janar-29 shkurt 2020;
- Aplikimi sipas formularëve standard të EBRD-së.

Me shkresën nr. 1297/1 datë 28/04/2020 “Miratim Pagese në favor të C. A.S.” në vlerën 243,887.14 Euro për faturat:

- Fatura T20/055 sipas Tabelës 1, Mallra të furnizuara nga jashtë;
- Fatura T20/056 sipas Tabelës 3, Shërbime Projektimi;
- Faturë T20/057 sipas Tabelës 4, Shërbime Instalimi dhe të tjera, Lot 2 Komani;
- Deklaratën për pagesën IPC 9 për periudhën 1-31 Mars 2020;
- Aplikimi sipas formularëve standard të EBRD-së.

Me shkresën nr. 1497/2 datë 17/06/2020 “Miratim Pagese në favor të C. A.S.” në vlerën 85,610.87 euro për faturat:

- Certifikatën e Përfundimit të Punimeve datë 06.02.2020, porta e remontit Nr.4, Lot 2 Komani;
- Fatura T20/091, sipas Tabelës 1 “Mallra dhe pjesë këmbimi të detyrueshme”;
- Fatura T20/092, sipas Tabelës 4 “Instalime dhe shërbime të tjera”;
- Aplikimi sipas formularëve standard të EBRD-së.

Me shkresën nr. 1676/1 datë 24/06/2020 “Miratim Pagese në favor të C. A.S.” në vlerën 266,679.01 euro për faturat:

- Fatura T20/102 sipas Tabelës 1, Mallra të furnizuara nga jashtë, Lot 2 Komani;
- Faturë T20/103 sipas Tabelës 4, Shërbime Instalimi dhe të tjera, Lot 2 Komani;
- Deklaratën për pagesën IPC 11 për periudhën 1-31 Maj 2020;
- Aplikimi sipas formularëve standard të EBRD-së.

Me shkresën nr. 1403/2 datë 16/06/2020 “Miratim Pagese në favor të C. A.S.” në vlerën 128,774.73 euro për faturat:

- Faturë T20/083 sipas Tabelës 4, Shërbime Instalimi dhe të tjera, Lot 2 Komani;
- Deklaratën për pagesën IPC 10 për periudhën 1-30 Prill 2020;
- Aplikimi sipas formularëve standard të EBRD-së.

Me shkresën nr. 6043/1, datë 20.12.2021 “Miratim Pagese në favor të C. A.S.” në vlerën 335,005.59 euro për faturat:

- Fatura T21/236 sipas Tabelës 1 “Mallra dhe pjesë këmbimi të detyrueshme ” SLG 3
- Fatura T21/236 sipas Tabelës 4 “Shërbime instalimi/shërbime të tjera” SLG 3
- Fatura T21/237 sipas Tabelës 1 “Mallra dhe pjesë këmbimi të detyrueshme” RG 3
- Fatura T21/237 sipas Tabelës 4 “Shërbime instalimi/shërbime të tjera” RG 3
- Fatura T21/238 sipas Tabelës 1 “Mallra dhe pjesë këmbimi të detyrueshme ” SLG 4
- Fatura T21/238 sipas Tabelës 1 “Shërbime instalimi/shërbime të tjera” SLG 4

- Fatura T21/239 sipas Tabelës 1 “Mallra dhe pjesë këmbimi të detyrueshme ” RG4
- Fatura T21/239 sipas Tabelës 4 “Shërbime instalimi/shërbime të tjera” RG 4
- Deklaratën e certifikatën Operacionale Nr. -1E;
- Aplikimi për pagesën pjesore sipas formularëve standard të EBRD – së
- Aplikimi për pagesën e mbetur në “client connection” MF 31.

Në procesin e pagesave u konstatua se faturat e vëna në dispozicion nga kontraktori nuk ishin në formatin që kërkohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. i ndryshuar, neni 49. Fatura tatimore (**shfuqizuar me Ligjin nr. 83/2019, datë 18.12.2019**); Neni 50 Fatura tatimore me TVSH (ndryshuar fjalë në pikën 1, me ligjin nr. 112/2016, datë 3.11.2016; **shfuqizuar me Ligjin nr. 83/2019, datë 18.12.2019**).

Faturat tatimore ishin lëshuar në afate të mëpasshme vetëm në funksion të rimbursimit të tvsh-së.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 315/5, datë 08.10.2025, “Deklaratë e njohjes dhe komentet përkatëse mbi projekt-raportin”

Pretendimi i subjektit:

Pasi u njohëm me projekt raportin paraqiten pretendimet e pasqyruara në të duke ju argumentuar si më poshtë vijon: Referuar ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu 3, Dispozita Administrative të Përgjithshme, Neni 24 citon “Dhënia e informacionit tatimor nga administrata tatimore u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme: Pika c) Kontrollit të Larte të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta; Pika ç) Autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar Marrëveshje Ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të Marrëveshjes. Kjo gjë është edhe për efekt të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave tatimore sipas nenit 25 "Konfidencialiteti", të po këtij ligji.

Kontrata nuk ka nr. protokollit të KESH” sqarojmë:

-Kontrata nuk ka nr. protokollit pasi bie ndesh me Vendimin nr.4, datë 19.06.2017, “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” neni 4, pika 9, citojmë: “ Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në Shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj”.

-Referuar Marrëveshjes së Huasë dhe kontratës së firmosur rrjedhoje e saj gjuha zyrtare e përcaktuar është Anglishtja. Në këtë kontekst asnjë nga partnerët e huaj, kontraktori i huaj apo Banka, nuk firmosin asnjë version të dokumentacionit në gjuhën shqipe. Pra kontrata në gjuhën Angleze pa u shoqëruar në versionin shqip të firmosur dhe konsideruar si kopje origjinale sipas ligjit nuk mund të protokollohet.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimet tuaja, ju sqarojmë se nuk keni sjellë fakte të reja, dokumentacion të ri justifikues apo argumente shtesë në lidhje me konstatimet e bëra e të trajtuara në Projekt-Raport.

Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Për sa më sipër mban përgjegjësi drejtuesi i Njësisë së Menaxhimit të Projekteve z. F. B..

2.6 Mirëmbajtja, vlerësimet mbi gjendjen e komponentëve të projekteve për sigurinë e digës dhe masat e marra për përmirësimin e tyre

KESH SHA është përgjegjës për monitorimin, mirëmbajtjen, shfrytëzimin normal të veprave hidroteknike në përgjithësi dhe digave e objekteve të tyre në veçanti, si dhe rehabilitimin dhe rritjen e efektivitetit dhe jetëgjatësisë së tyre. Dimensionet/lartësia, vendndodhja dhe lloji i digave, liqenet e krijuara nga ndërtimi i tyre, si dhe dinamika e operimit të HEC-ve, e bëjnë kaskadën e lumit Drin mjaft të veçantë për të gjithë Evropën. Aktualisht, kaskada e lumit Drin përbëhet nga 6 diga të mëdha, ndërtimi i të cilave ka bërë të mundur krijimin e 3 ujëmbledhësve artificialë dhe shfrytëzimin për energji elektrike të pellgut ujëmbledhës të lumit më të madh të vendit tonë, lumit Drin. Digat e kaskadës së lumit Drin të administruara nga KESH SHA, për vetë rëndësinë ekonomike dhe teknike të tyre, madhësisë, llojit, mënyrës së shfrytëzimit dhe ndikimit shoqërorë dhe mjedisor në zonë, janë konsideruar si diga të klasit të parë.

Diga e HEC Komanit është digë me material vendi, pra mbushje e trupit të digës me material vendi dhe ka si element papërshkueshmërie të saj, një ekran betonarmeje dhe perde kundra filtrimi në shpatë dhe në themel të digës. Lartësia e digës është 115.5 m. Kjo digë ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1985. Me përfundimin e ndërtimit të saj është krijuar ujëmbledhësi i HEC Koman i cili është afro 5 herë më i vogël se ujëmbledhësi i HEC Fierzë. Me volum total të projektuar, prej afro 500 milion m³ ujë. Referuar matjeve batimetrike të vitit 2015, rezultoi një volum afro 432 milion m³ ujë, ndërsa referuar matjeve batimetrike të vitit 2023, rezultoi që ky volum të jetë në afro 440 milion m³ ujë.

Baza kryesore ligjore për kryerjen e aktiviteteve të monitorimit dhe mirëmbajtjes së digave dhe objekteve të tyre, në kuadër të sigurisë së digave përgjatë shfrytëzimit për prodhimin e energjisë elektrike, është Ligji Nr. 8681, datë 02.11.2000, "Për Projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave". Në veprimtarinë e përditshme në lidhje me monitorimin dhe shfrytëzimin e digave, KESH sh.a., është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 18.03.2004 i cili ka miratuar "Rregulloren për Sigurinë e Digave dhe të Dambave".

Projekti "Fuqizimi i programit të Sigurisë së Digave" është një projekt i filluar në 30.06.2008 datë në të cilën u hartua edhe Dokumenti i Vlerësimit të Projektit (PAD) i cili ka përlllogaritur një kosto totale prej 110.5 mln € (112.66 mln USD) dhe është një bashkëfinancim i 5 donatorëve të ndryshëm:

IDA – Shoqata ndërkombëtare për zhvillim;

EBRD – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;

IBRD – Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim;

SECO – Qendra e Konfederatës Zvicerane;

KfW – Instituti i Kreditimit të Investimeve;

Projekti i bërë efektiv në vitin 2008 synon:

-Përmirësimin e eficiencës operative të këtyre digave;

-Rritjen e qëndrueshmërisë në furnizimin me energji në tregun rajonal;

Në kuadër të objektivave të programit rajonal për Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore, është firmosur Marrëveshja Financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA) si dhe Marrëveshja e Projektit ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH SHA) dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA) në lidhje me Projektin e Sigurisë së Digave në hidrocentralet e kaskadave të lumenjve Drin dhe Mat. Objektivat kryesore të Projektit të Sigurisë së Digave në kuadrin e programit rajonal ECSEE APL5 janë:

- Rritja e sigurisë së digave të hidrocentraleve më të mëdha të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat;

- Rritja e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të eficiencës së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në rritjen e qëndrueshme të sigurisë së furnizimit me energji elektrike në tregun rajonal të energjisë;

Projekti i Sigurisë së Digave, është projekt i një rëndësie prioritare për sistemin elektroenergjetik dhe për Shqipërinë. Realizimi i projektit të sigurisë së digave, do të krijojë të gjitha premiset për rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet optimizimit të përdorimit të rezervës hidroenergjetike në kaskadat e lumenjve Drin dhe Mat si dhe nëpërmjet instalimit të sistemeve moderne të kontrollit dhe automatizimit. Nëpërmjet një mirë menaxhimi të hidrocentraleve ekzistuese do të rritej vlera e aseteve të gjenerimit si dhe do të krijoheshin mundësitë për një pjesëmarrje efektive të Shqipërisë në tregun rajonal të energjisë elektrike “Studimi mbi Sigurinë e Digave të hidrocentraleve të kaskadave të lumenjve Drin dhe Mat”, i financuar në vitin 2006 nga Qeveria Zvicerane e përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO), ka bërë një analizë të thellë të gjendjes aktuale të këtyre digave në Shqipëri. Investimet e identifikuara nga ky studim mund të përmbliidhen nëpërmjet realizimit komponentëve si më poshtë;

- Rehabilitimin e veprave shkarkuese;
- Instalimin e sistemeve të reja të kontrollit dhe monitorimit;
- Mbrojtjen nga rreziku i rënies së shkëmbinjve rreth shpateve të digave;
- Përmirësimin dhe garantimin e rrugëve hyrëse në godinat e centraleve, digave dhe galerive të drenazhit;
- Studimin batimetrik të baseneve;
- Rishikimin e hidrologjisë së kaskadave të lumenjve Drin dhe Mat;
- Punimet në bjefet e poshtme të këtyre hidrocentraleve me qëllim eliminimin e sedimenteve të ngurta, etj.

Studimi i detajuar i fizibilitetit, i financuar nga Qeveria Zvicerane e përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO), ka shërbyer si bazë për përgatitjen e Projektit për implementimin e të gjitha investimeve të parashikuara në kuadrin e projektit të Sigurisë së Digave. Projekti i implementimit të masave për Sigurinë e Digave është realizuar nëpërmjet një financimi të përbashkët të Bankës Botërore institucioneve të tjera financiare si SECO, EBRD, KfW, KESH etj. Masat mbrojtëse për shpatet e digave kanë përfunduar sa i përket HEC Fierzë dhe Koman, Sistemi i kontroll monitorimit është në proces zbatimi në HEC Koman. Janë realizuar sistemet përkatëse të monitorimit për HEC Fierzë. Janë realizuar sistemet e monitorimit gjeologjik dhe sizmik. Ka përfunduar rehabilitimi i katër Agregateve të HEC-Koman. Ka përfunduar mbrojtja e bjefit të poshtëm të skarpatës së digës për HEC Koman dhe i portave të shkarkimit. Menaxhimi dhe implementimi i këtij projekti realizohet nëpërmjet Departamentit të Projekteve të Rehabilitimit të Hidrocentraleve të KESH SHA.

Realizimet Projekti për Sigurinë e Digave 2009 - 2021				
Aktivitetet		Monedha	Shuma Totale e Kontrates	Realizim Kontrate
Banka	Rehabilitimi E-M dhe Instalimi i Sistemit të Monitorimit të HEC-it Koman, A. H. GmbH, Austria	EURO	17,182,472.68	Realizuar
	Paneli i eksperteve të pavarur - B.P., P.Co, J.S., P.M.,P.M.	EURO	527,935.24	Realizuar

	Asistence Teknike në Implementimin e Projektit – A. C, Switzerland	EURO	5,821,790.71	Realizuar
	Prokurimi dhe blerja e Pajisjeve te IT dhe arkives për Departamentin e Projektit te Sigurisë se Digave ne KESH	EURO	41,717.64	Realizuar
	Trajnim stafi	EURO	5,826.65	Realizuar
	DRP-Paneli i pavarur lokal i eksperteve M.S.	EURO	31,746.56	Realizuar
	DSP-IDA 07-11 Tur studimor ne SHBA dhe Kanade për Fuqizimin institucional te sigurisë se digave dhe përgatitja e planeve te emergjencës - U.S. E.A. USEA	EURO	60,835.32	Realizuar
	Shërbim Konsulence për Forcimin e Programit te Sigurisë se Digave, Implementimin e Metodologjisë se Riskut dhe Përgatitja e Planeve Paraprake te Emergjencës	EURO	290,817.99	Realizuar
	Shërbim Konsulence për Studimin Përgatitor, Studimin e Fizibilitetit, Hartimin e Projektit te Tenderit dhe te Specifikimeve Teknike te Menaxhimit te Sigurt te Plotave për HEC-et e Kaskadës se Drinit. , F., Germany	EURO	2,021,358.50	Realizuar
	Asistence teknik për studimin për vlerësimin e potencialeve hidrogjeneruese të lumenjve Drin e Vjose – S., France	EURO	381,455.00	Realizuar
	1.1 DSP-IDA 05-16 Spillway Gates and Stoplogs Rehabilitation of Fierza HPP and Rebuilding Fierza Gate House/ C. A.S.Turkey Lot 1.	EURO	6,143,393.68	Realizuar
	DSP IDA 04-11 Rehabilitimi E-M dhe Instalimi I Sistemit te Monitorimit te HEC-it Koman, A. H. GmbH, Austria	EURO	10,116,384.10	Realizuar
EBRD	Konsolidimi i Bjefit te Poshtëm te Digës se Komanit dhe Largimi i Depozitimeve ne Kanal in e Shkarkimit, P. B., Austria.	EURO	5,619,573.61	Realizuar
	Category 3 . Goods and Works for Part C DSP-IDA 05-16 Rehabilitation of Spillway Gates and Stoplogs of Komani HPP/ C. A.S Turkey Lot 2	EURO	6,128,224.00	Realizuar
	Masat për mbrojtjen nga rënia e shkëmbinjve Komani H., C. FRANCE	EURO	830,959.37	Realizuar
SECO	Monitorimi Gjeodetik i Sigurisë se Digave për 5 HEC-et, B. S., Switzerland	CHF	638,286.90	Realizuar
	Monitorimi Gjeologjik dhe Sizmik i Sigurisë se Digave për 5 HEC-et, S., Switzerland	CHF	2,493,624.30	Realizuar
	Modelimi Stokatik i rënies se shkëmbinjve Fierza, E. Zurich, Switzerland	CHF	46,869.00	Realizuar

Additional Mandate in Strengthening Dam Safety Capacity of KESH/ A. P. AG	CHF	145,650.00	Realizuar
Masat për mbrojtjen nga rënia e shkëmbinjve Fierzë H., C., Switzerland	CHF	2,134,205.00	Realizuar

Në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të punës së KESH SHA, si dhe me strukturën organizative të aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës, pranë Divizionit Teknik funksionojnë veç të tjerave, tre njësi kryesore dhe tre njësitë lokale të prodhimit të cilat janë:

- Departamenti i Veprave Hidroteknike (DVHT), puna e së cilës fokusohet kryesisht tek siguria e digave. Për këtë DVHT ndjek monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave gjatë shfrytëzimit të tyre.
- Departamenti Elektromekanik (DEM) i cili ndjek në tërësi aktivitetin e mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve elektromekanike të instaluar në çdo HEC.
- Njësia e Menaxhimit të Projekteve me Financim të Huaj (NjMPFH) e cila ndjek projektet rehabilituese që realizohen nga financimet e huaja.
- Departamenti i Zhvillimit të Burimeve Gjeneruese (DZhBGj)
- Njësitë e Prodhimit HEC-et Fierzë, Koman, Vau Dejës.

Detyrat kryesore të DVHT të listuar sipas Rregullores së Punës në KESH sh.a. janë:

- Kryerja e kontrolleve periodike e vizuale në të gjitha digat dhe nën-objektet e saj.
- Kryerja e kontrolleve të sistemeve të shkarkimit dhe shuarësve të energjisë.
- Kontrollet vizuale të qëndrueshmërisë së brigjeve të ujëmbledhëseve në se ka rrëshqitje apo erozion.
- Kontroll, përpunim dhe interpretim i të dhënave të marra gjatë matjeve të aparaturave të sistemeve të monitorimit gjeodezik, hidrogjeologjik, hidrologjik, sizmik, gjeologjik, hidroteknik të vendosura në objektet dhe nën-objektet përkatëse të digave dhe të zonave të veçanta që ndikojnë në to.
- Ndjekje e punës së reparteve hidroteknike në njësitë e prodhimit në HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës,
- Monitorimin e sasisë së prurjeve dhe reshjeve në kaskadën e lumit Drin,
- Koordinimin e punëve me Divizionin e Operimit dhe të Tregtimit / Departamentit të Operacioneve të Prodhimit DOT/DOP, për ndjekjen dhe zbatimin e rregullores së shkarkimit të plotave,
- Koordinimin e punëve me DEM për kontrollin dhe monitorimin e pjesëve elektromekanike të sistemeve të shkarkimit dhe të dërgimit të ujit në turbina, etj.
- Koordinimin e punëve me DEM dhe me DTIKA për mirëmbajtjen e sistemeve automatike të monitorimit të digave.
- Kontrollin dhe aprovimin e projekteve dhe ndjekjen e zbatimit të tyre në kuadër të rehabilitimit, monitorimin dhe mirëmbajtjen e të gjithë nën-objekteve të digave,
- Hartimin e raportit vjetor për monitorimin dhe mirëmbajtjen e digave, gjendjen e tyre dhe ujëmbledhësve të kaskadës së lumit Drin gjatë shfrytëzimit.

Planifikimi i mirëmbajtjes

Bazuar në rregulloren e shfrytëzimit, të miratuar në 1988, dhe në praktikën e trashëguara që nga koha e vënies në shfrytëzim të hidrocentraleve, planifikimi i remonteve është me bazë kohore. Kjo do të thotë që shërbimet remontuese planifikohen në mënyrë periodike brenda vitit ose 6 mujorit.

Në fillim të çdo vitit hartohet plani grafik i remonteve në koordinim me Departamentin e Operimit, dhe miratohet nga drejtori i Divizionit Teknik.

Planifikimi i remonteve përveç bazës kohore, varet nga shume faktorëve te tjerë siç janë:

-Regjimi i prodhimit ne varësi te prurjeve.

-Gjendja teknike e pajisjeve.

-Planifikimi i realizimit te punimeve te investimeve që kërkojnë ndalim te aggregateve.

Programi i remonteve të planifikuara

Qëllimi i remonteve të planifikuara është garantimi i gatishmërisë për shfrytëzim dhe rritja e jetëgjatësisë së pajisjeve.

Programi i punimeve gjate remonteve te planifikuara hartohet përpara fillimit të çdo remonti, dhe shërben si udhëzues për të gjitha punimet qe do te realizohen.

Për hartimin e programit merren për baze:

-Rregullorja e shfrytëzimit;

-Rregullorja e sigurimit Teknik;

-Raportet e sistemeve te monitorimit ne kohe reale (sistemet e monitorimit te transformatorëve DGA BMT, sistemet e monitorimit shkarkimeve pjesore, monitorimi i vibrimeve etj)

-Manualet e pajisjeve dhe sistemeve në mënyrë specifike;

-Standarde te matjeve dhe analizave, te izolacionit vajrave etj.

-Historiku i defekteve dhe problematikave te raportuara nga operatorët, dhe sistemi SCADA.

Për asetet kryesore te prodhimit te energjisë elektrike, KESH ka te trashëguar një eksperiencë shume vjeçare te shërbimeve mirëmbajtëse qe realizohen, dhe vazhdon te zbatohet kjo praktike, e dokumentuar me raporte dhe akte teknike.

Me zhvillimin e teknologjive, specifikisht me automatizimin e shume proceseve, janë thjeshtuar proceset operative, por nga ana tjetër shërbimet mirëmbajtëse kërkojnë një staf më të kualifikuar dhe të specializuar për sisteme të veçanta. KESH SHA ka realizuar trajnime për kapacitetet e burimeve njerëzore që ka, gjithashtu për sisteme qe nuk ka kapacitete njerëzore të kualifikuara për mirëmbajtje janë lidhur kontrata mirëmbajtje me palë të treta.

Remonte të pa planifikuara (defekte).

Qëllimi i remonteve të pa planifikuara është lokalizimi i defekteve në mënyrë të shpejtë dhe minimizimi i kohës jashtë gatishmërisë të aggregateve.

Në ndryshim nga remontet e planifikuara shfaqja e defekteve është rastësore, dhe kërkon një reagim të shpejte të stafeve të mirëmbajtjes.

Defektet ndahen në dy grupe kryesore:

-Defekte që shoqërohen me ndryshim parametrash në nivel alarmi.

-Defekte që shoqërohen me hedhje në avari.

Gatishmëria për raste të veçanta.

Nisur nga rëndësia e detyrimit te KESH për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në vend dhe sigurisë së menaxhimit të plotave në raste reshjesh të shumta stafet e mirëmbajtjes mobilizohen me urdhra të veçanta si në rastet më poshtë:

-Urdhër gatishmërie në raste festash, ka si qellim prezencën e shtuar të stafeve të mirëmbajtjes për të minimizuar kohen e shfaqjes së ndonjë defekti.

-Urdhër gatishmërie për operimin e portave te shkarkimit, ka si qellim hartimin e grafikeve te stafeve të mirëmbajtjes me qëndrim në HEC-ce për të mirë menaxhuar prurjet gjate kohës se reshjeve.

Nga shqyrtimi i dokumenteve u konstatua se KESH SHA procedurat për mirëmbajtje për investimet nga projektet nuk i ka formalizuar në rregullore të veçanta por i ka bërë pjesë integrale të rregulloreve të mëparshme, si dhe rregullores bazë.

Në lidhje me operimin dhe mirëmbajtjes së hidrocentraleve strategjia, diagnostifikimi i performancës, vlerësimi i risqeve sistemike, vlerësimet e gjendjes së aseteve, modelet

strategjike kanë nevojë për rishikime pasi mbështeten në rregullore të viteve të mëparshme pa vlerësuar risqet në rritje nga ndryshimet.

Sa më sipër është jo në përputhje me pjesën e II, Menaxhimi i riskut lidhur me aktivet, pikat 17-22, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2008 ka filluar Projekti “Fuqizimi i programit të Sigurisë së Digave” me bashkëfinancim të donatorëve të ndryshëm, IDA –Shoqata ndërkombëtare për zhvillim; EBRD –Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim; IBRD –Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim; SECO –Qendra e Konfederatës Zvicerane; KfW –Instituti i Kreditimit të Investimeve, me objekt rritjen e sigurisë së digave të hidrocentraleve në kaskadën e Drinit. Huaja e marrë nga BERZH në vitin 2012 në shumën 12,700,000 euro për përmirësimin e sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit nuk u shfrytëzua plotësisht duke lënë vlerën 6,128,224 euro kredi jo e disbursuar. Më datë 21.12.2016 EBRD ka njoftuar Ministrinë e Financave për shtyrjen e afatit të disponibilitetit të shumës së mbetur pas kërkesës së marrësit deri më 31.12.2018.

Në raportet e projektit të Bankës Botërore për Sigurinë e Digave, me nr. P110481, filluar më datë 31.12.2013 dhe përfunduar më datë 31.12.2016, është evidentuar nevoja për rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC-it të Fierzës dhe Komanit dhe përfaqësuesi i IBRD i ka dërguar një shkresë Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës, për dijeni dhe Ministrisë të Financave ku parashtron urgjencën e rehabilitimit të portave të shkarkimit, bashkëpunimin intensiv me KESH SHA për finalizimin e plotësimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit, si dhe kërkon bashkëpunimin e të gjithë institucioneve për t’i kompletuar deri në shtator të 2016.

-Drejtuuesi i Njesisë së Menaxhimit të Projekteve ka ndërmarrë veprime për zhvillimin e procedurës së prokurimit për llogari të IBRD, sipas rregulloreve të kësaj banke, me zbatues KESH SHA, me objekt rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC-it të Fierzës dhe Komanit, në periudhën maj-shtator 2016 pa pasur një autorizim ose urdhër nga titullari i KESH, veprim në kundërshtim me neni 14.4 të Statutit të Shoqërisë, të ndryshuar, miratuar me shkresën nr. 2216/1 prot., datë 26.04.2011 të Aksionerit të Përgjithshëm METE, dhe Rregulloren e Shoqërisë të vitit 2014, ku përcaktohen qartë kompetencat e administratorit dhe drejtuesit të Njesisë së Menaxhimit të Projekteve, duke mos pasur kompetenca për të përfaqësuar shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqe nr. 21-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Administratori i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare SHA të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, me qëllim parandalimin e rasteve kur punonjësit ndërmarrin veprime në emër të shoqërisë pa pasur miratimin apo urdhrat përkatës.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procedurën e filluar në maj të vitit 2016 nga drejtuesi i Njesisë së Menaxhimit të Projekteve të KESH SHA, për llogari të IBRD, me objekt rehabilitimin e portave të shkarkimit të HEC-it të Fierzës dhe Komanit, administratori i KESH SHA, me shkresën nr. 41, datë 19.09.2016, nr. 7801 prot., ka urdhëruar ngritjen e një komisioni

për vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik, bazuar në Ligjin nr. 40/2012 datë 12.04.2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).

Urdhri i mësipërm nuk është i saktë pasi marrëveshja e huasë ishte e përfunduar në momentin e lëshimit të urdhrit.

Më datë 10.10.2017 administratori i KESH SHA, i është drejtuar shoqërisë C. A.S, me shkresën nr. 5126 prot., për ta njoftuar se oferta e tyre në vlerën 12.340.903 euro për dy lotet është pranuar, dhe më datë 07.06.2018 është firmosur kontrata me nr. DSP-IDA 05-16, pa numër protokolli.

Ministri i Financave me shkresën me nr. 17494 prot., datë 01.12.2017 i ka kërkuar Bankës Botërore akordimin e një financimi shtesë në vlerën e 12,000,000 euro, në kuadër të marrëveshjes së mëparshme për Sigurinë e Digave.

Më datë 21.06.2018 është pranuar marrëveshja ndërmjet IBRD dhe KESH SHA për huanë me nr. 8862-AL në lidhje me implementimin e projektit, e firmosur nga administratori i KESH SHA dhe përfaqësuesi i IBRD. Kontrata nuk ka numër protokolli të KESH SHA. Administratori i KESH SHA nuk kishte kompetenca për lidhjen e marrëveshjes me IBRD pasi Kuvendi i Shqipërisë e ka ratifikuar marrëveshjen e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave, për vlerën 12,000,000 euro, më datë 20.09.2018. Në shtojcën e ligjit, pikat 5-6 përcaktohet se “bashkë-financues” është Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe shuma është 6,100,000 euro.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 12879/6 prot., datë 19.10.2018 i ka dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe KESH SHA kopjen e dokumentit ndryshues të marrëveshjes së huasë me BERZH.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se përfaqësuesit e KESH SHA, konkretisht administratori dhe drejtuesi i Njesisë së Menaxhimit të Projekteve, kanë iniciuar procedura prokurimi pa pasur në dispozicion miratimin e financimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe pa ratifikimin përkatës nga Parlamenti i Shqipërisë. Si rrjedhojë, kontratat janë lidhur në mungesë të një financimi të aprovuar dhe të ratifikuar nga këto institucione. Veprimet e ish administratorit të KESH janë në kundërshtim me statutin e shoqërisë KESH SHA, neni 11, pikat iv, v dhe vi, ku përcaktohet se angazhimet për lidhjen e detyrimeve të reja financiare fillimisht miratohen në Këshillin Mbikëqyrës për të kaluar në aprovimin përfundimtar të Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqe nr. 21-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës Elektroenergjitike të Shqipërisë të marrë masat që, në të ardhmen, procedurat që lidhen me investimet, huamarrjen dhe përfaqësimin e shoqërisë ndaj palëve të treta të realizohen vetëm pas autorizimit nga Këshilli Mbikëqyrës dhe miratimit nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës së disbursimit dhe pagesave të faturave rezultuan mos përputhjet si vijon: Me shkresën nr. 4871 prot., datë 13.09.2018, Njësia e Menaxhimit të Projekteve ka kërkuar “Miratimin e parapagesës ndaj C. A.S.” në vlerën 631,654.37 euro për faturën e parapagimit lëshuar më datë 06.06.2018, në vlerën 10 % të kontratës. BERZH me shkresën datë 27.11.2018 njofton KESH SHA, se data efektive e Amendimit të Marrëveshjes do të jetë data 27.11.2018.

Më datë 05.12.2018, KESH SHA ka përcjellë tek BERZH praktikën për disbursimin e 10 % parapagesë, sipas kushteve të kontratës kundrejt faturës dhe një garancie të pakthyeshme për të njëjtën vlerë. Për sa më sipër nga Njësia e Menaxhimit të Projekteve është aprovuar

dokument i lëshuar nga kontraktori (advance payment bill), në një datë kur kontrata mes palëve nuk ishte e lidhur, duke rezultuar në tejkalim të kompetencave të tyre.

Fatura tatimore për parapagesën është lëshuar nga kontraktori në janar të vitit 2019 (ose 6 muaj më vonë se fatura e lëshuar për disbursim), veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 99-101 ku përcaktohen vendi, momenti, përshkrimet e mallrave ose furnizimeve.

-Në procesin e pagesave të faturave të kontraktorit u konstatua se faturat e vëna në dispozicion nuk ishin në formatin që kërkohet sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. i ndryshuar, nenet 49-50.

Njësia e Menaxhimit të Projekteve ka aprovuar dokumentet për rimbursim të kontraktorit, si “faturë tregtare”, dokument jo në përputhje me termat e kontratës mes palëve, dhe jo në formatin e aprovuar nga Ministri i Financave. Faturat tatimore ishin lëshuar në afate të mëpashme vetëm në funksion të rimbursimit të TVSH-së. Një pjesë e pagesave nga BERZH janë kryer në llogarinë e shoqërisë mëmë në Turqi, kur faturat tatimore janë lëshuar nga Dega e shoqërisë në Shqipëri. Të gjitha praktikat për disbursim dërguar Bankës janë miratuar nga administratori dhe drejtori i departamentit ekonomik i KESH SHA.

Parregullsitë e konstatuara rrisin riskun e mospagesave të detyrimeve tatimore nga ana e kontraktuesve të huaj që zbatojnë kontrata të prokuruar nga Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqe nr. 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë dhe Drejtori i departamentit ekonomik të marrin masa që operatorët ekonomik fitues të procedurave të prokurimit të fondeve me financim të huaj, në rast se në marrëveshjen e ratifikuar nuk është parashikuar ndryshe, duhet të zbatojnë rregullat dhe legjislacionin fiskal të Republikës së Shqipërisë, me qëllim shmangien dhe mos pagimin e detyrimeve tatimore që mund të krijohen gjatë zbatimit të kontratave.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumenteve për mirëmbajtjen e aseteve u konstatua se KESH SHA, procedurat për mirëmbajtje për investimet nga projektet nuk i ka formalizuar në rregullore të veçanta por i ka bërë pjesë integrale të rregulloreve të mëparshme, si dhe rregullores bazë.

Në lidhje me operimin dhe mirëmbajtjen e hidrocentraleve strategjia, diagnostikimi i performancës, vlerësimi i risqeve sistemike, vlerësimet e gjendjes së aseteve, modelet strategjike kanë nevojë për rishikime pasi mbështeten në rregullore të viteve të mëparshme pa vlerësuar risqet në rritje nga ndryshimet mjedisore e klimaterike.

Sa më sipër është jo në përputhje me pjesën e II, Menaxhimi i riskut lidhur me aktivet, pikat 17-22, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6. faqe nr. 29-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë, Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë të marrë masa për evidentimin dhe vlerësimin e gjendjes së aseteve, duke rishikuar rregulloret ekzistuese për përditësimin me standardet më të mira për operimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Referuar marrëveshjes së huasë, Ministria e Financave, si huamarrëse, është e angazhuar të shlyejë huanë në 26 këste të barabarta gjashtëmujore, të cilat përkojnë me datat e pagesës së interesit. Nga auditimi rezultoi se pagesat e interesit kanë filluar në vitin 2013, ndërsa pagesat për principalin kanë nisur në vitin 2015.

Deri më datë 31.12.2024, Ministria e Financave ka kryer pagesa në vlerën 949,029 euro për interesin dhe 8,531,111 euro për principalin, si dhe janë paguar 443,624 euro në formë komisionesh.

Në bazë të marrëveshjes së huasë, është lidhur një Marrëveshje e nënhuasë ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, ku përcaktohet që të gjitha detyrimet financiare i kalojnë KESH SHA për efekt shlyerjeje. Megjithatë, auditimi konstatoi se, KESH SHA ka realizuar vetëm dy pagesa minimale në vitin 2014: 3,382 euro për interes dhe 99,739 euro për komisione. Si rezultat, KESH SHA ka një detyrim të mbartur ndaj Ministrisë së Financave në vlerën 9,820,643 euro, duke transferuar në mënyrë të pajustificuar kostot financiare ekstra mbi buxhetin e shtetit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me seksionet 3.03 dhe 3.04 të Marrëveshjes së Nënhuasë, si dhe kanë ngarkuar buxhetin e shtetit me kosto ekstra dhe detyrime të cilat duhet të mbulojë KESH SHA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqe nr. 14-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marri masa për hartimin e një marrëveshje dhe skeduli për kryerjen e pagesave të detyrimeve të prapambetura të kësaj kredie.

Në vijimësi

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Referuar nenit 2, pika h, e Marrëveshjes së Financimit, norma e tarifës së angazhimit do të jetë 0.5 % në vit për t'u llogaritur dhe e pagueshme në përputhje me seksionin 3.05 të termave dhe kushteve standarde. Nga auditimi rezultoi se për shkak të zgjatjes së afatit të zbatimit të projektit, mos disbursimit në kohë dhe jo sipas skedulit të parashikuar në marrëveshjen e financimit të huasë të fondeve të vendosura në dispozicion, Ministria e Financave ka paguar ndaj EBRD vlerën prej 316,624.52 euro, e cila është kosto shtesë për Ministrinë së Financave dhe KESH SHA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqe nr. 14-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Korporata Elektroenergjitike e Shqipërisë, të marrë masa që në implementimin e projekteve me financim të huaj ti përmbahet grafikut kohor të zbatimit të tij, me qëllim eliminimin e efekteve financiare dhe rritjen e kostos së tij.

Në vijimësi

C1. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, në nenin 37, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës dhe administratori i KESH, të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë disiplinore për veprimet e kryera nga drejtuesi i Njësisë së Menaxhimit të Projekteve F. B. duke nisur procedurat për dhënien e masave disiplinore, në përputhje me kuadrin ligjor të rregullimit të marrëdhënieve përkatëse të punës .

C2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjës të mëposhtëm nuk rekomandojmë masë disiplinore, sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të saj:

1. A. H., ish Administrator i KESH SHA.
- 2.

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT